

GJYKATA E QARKUT TË PRISHTINËS

P. Nr. 488/08

22 shtator 2009

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut të Prishtinës, me trupin gjykues të përbërë nga:

Gjykatësi i EULEX-it, Z. Françesko Florit, gjykatës kryesues
Gjykatësi EULEX-it, Z. Tron Gundersen, anëtar i trupit gjykues
Gjykatësja vendore, Znja. Zahide Gjonaj, anëtar i trupit gjykues

Me ndihmën e procesmbajtëses Nexhmije Mezini

Në lëndën penale kundër:

Besnik Hasanit, i lindur më 27 tetor 1976 në Firajë, Shtërpcë, shqipëtar i Kosovës, emri i babait Arif, emri i nënës Nazlije, profesioni i mëhershëm polic, shkollën e mesme të kryer, i pamartuar, pa dosje penale, në paraburgim që nga 21 janari 2008.

Shpend Qerimit, i lindur më 18 shtator 1974 në Ferizaj, shqipëtar i Kosovës, emri i babait Mustafë, emri i nënës Shefike, profesioni i mëhershëm polic, shkollën e mesme të kryer, i martuar, baba i tre fëmijëve, pa dosje penale, në paraburgim që nga 21 janari 2008.

Nusret Cenës, i lindur më 1 janar 1975 në Doganaj, Kaçanik, shqipëtar i Kosovës, emri i babait Isen, emri i nënës Merushe, pjesëtar i TMK-së, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve.

Të gjithë të akuzuarit akuzohen për veprat penale:

- a). **Vrasje e rëndë në bashkëkryerje**, sipas nenit 147, paragrafi 4, 9, dhe 11 dhe nenit 23 të KPK-së;
- b). **Lëndim i rëndë trupor në bashkëkryerje**, sipas nenit 154, paragrafi 1, n. 1 të KPK-së; dhe
- c). **Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm në bashkëkryerje**, sipas nenit 291, paragrafi 1 dhe 5 dhe nenit 23 të KPK-së.

Pas seansave gjyqësore të mbajtura më 5, 12, 14, 19, 20, 25, 28 maj; 2, 3, 8, 9, 16, 30 qershor; 1, 2 korrik; 19, 25, 26 gusht; dhe 2, 3 shtator 2009, në praninë e prokurores së EULEX-it nga PSRK Znjës. Maria Bamieh, të akuzuarve të lartpërmendur dhe avokatëve të tyre;

Pas mbledhjes së trupit gjykues për të marrë vendim, të mbajtur më 17 shtator 2009;

Duke u bazuar në nenin 391 (1) të Kodit të procedurës penale të Kosovës (KPPK-së)

Shpalli në publik dhe në praninë e të akuzuarve, avokatëve të tyre dhe prokurores publike dhe lëshoi këtë këtë:

AKTGJYKIM

Besnik Hasani dhe **Shpend Qerimi** shpallen fajtorë për veprat penale:

- a) vrasje e rëndë, në kundërshtim me nenin 147, paragrafi 4, 9, dhe 11 të KPK-së,
- b) lëndim i rëndë trupor, në kundërshtim me nenin 154, par. 1, p.1 KPK-së
- c) shkaktim i rrezikut të përgjithshëm në kundërshtim me nenin 291, paragrafi 1 dhe 5 të KPK-së.

Të gjitha këto krime të kryera në bashkëkryerje nga neni 23 të KPK-së.

I akuzuari **Besnik Hasani** dhe **Shpend Qerimi** janë shpallur fajtorë për veprat e përshkruara në pikat 2, 3, dhe 4 të aktakuzës fillestare me rekualifikim të fakteve të pikës 3 nga neni 154, par. 1, p.1 të KPK-së CCK (lëndim i rëndë trupor).

Më veçanërisht, Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi,

Pika 2 e aktakuzës fillestare

Më 24 shtator 2007, **Besnik Hasani** dhe **Shpend Qerimi** duke vepruar dhe kryer bashkë njëri me tjetrin si dhe me individë identiteti i të cilëve është ende i panjohur, kanë privuar nga jeta persona të tjerë për hakmarrje të paskrupullt dhe motive tjera të ulëta, duke vendosur dhe kryer shpërthimin e një mjeti shpërthyes të improvizuar në katin përdhesë të një ndërtese në Bulevardin Bill Clinton, Prishtinë, akt ky i cili ka rezultuar me vdekjen e Naim Murtit dhe Pleurat Sllamnikut, dhe duke vepruar kështu, ata me qëllim kanë vënë në rrezik jetën e më shumë personave;

Duke kryer kështu veprën penale **të vrasjes së rëndë**, në kundërshtim me **KPK-në, nenin 147, par. 4,9 dhe 11, në bashkëkryerje, neni 23 i KPK-së.**

Pika 3 e aktakuzës fillestare

Më 24 shtator 2007, **Besnik Hasani** dhe **Shpend Qerimi**, duke vepruar dhe kryer bashkë njëri me tjetrin si dhe me individë identiteti i të cilëve është ende i panjohur, i kanë shkaktuar lëndim të rëndë trupor Xh S, V Z, L Nt, G S, E St, N Ht, F B, L K, dhe Sh S, duke vendosur dhe kryer shpërthimin e një mjeti shpërthyes të improvizuar në katin përdhesë të një ndërtese në Bulevardin Bill Clinton, Prishtinë

Duke kryer kështu veprën penale **të lëndimit të rëndë trupor**, në kundërshtim me **KPK-në, neni 154, par. 1, p.1 KPK-së, në bashkëkryerje, neni 23 i KPK-së.**

Pika 4 e aktakuzës fillestare

Më 24 shtator 2007, **Besnik Hasani** dhe **Shpend Qerimi** duke vepruar dhe kryer bashkë njëri me tjetrin si dhe me individë identiteti i të cilëve është ende i panjohur, duke përdorur mjete shpërthyes, konkretisht, një mjet shpërthyes të improvizuar i cili është vendosur dhe ka shpërthyer në katin përdhese të një ndërtese në Bulevardin Bill Klinton, Prishtinë, kanë shkaktuar rrezik të madh për jetë të njeriut, akt ky i cili ka rezultuar me vdekjen e Naim Murtit dhe Pleurat Sllamnikut, dhe me lëndime të rënda trupore ndaj nëntë personave, konkretisht ndaj Xh St, V Zt, L Nt, G S, E St, N Ht, F B, L K, Sh S, Milot Kadriut dhe Teuta Kadriut, dhe dëme të mëdha materiale në pronë, konkretisht në lokalet Ciko, Besa, Uran, Shped, Oslo, Pasazh, Noti, Kojota, Fitness Klub dhe Sekiraqa;

Duke kryer kështu veprën penale *të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm*, në kundërshtim me KPK-në, **nenin 291, par. 1 and 5, në bashkëkryerje, neni 23 i KPK-së.**

Based on article 390, n.3 KCCP,

1. Nusret Cena

Në lidhje me të njëjtat vepra penale nuk shpallate fajtor, prandaj edhe lirohet.

Për arsye të cekura më lartë, trupi gjykues lëshon këtë

DËNIMI

2. **Besnik Hasani**

Sipas nenit 37 të Kodit penal të Kosovës dhe nenit 147 par. 1, pika. 4, 9 dhe 11 dhe nenit 23, dënohet me burgim të gjatë 25 vjet;

Sipas nenit 154, par. 1, pika.1 dhe 23 të KPK-së dënohet me 3 vjet burgim;

Sipas nenit 291, par. 1 dhe 5 dhe nenit 23 të KPK-së dënohet me 3 vjet burgim.

Sipas nenit 71, par. 1 dhe 2, p.1, 2 të Kodit penal të Kosovës, i akuzuari Besnik Hasani, **do ta vuajë dënimin me burgim të gjatë 25 vjet.** .

3. Shpend Qerimi

Sipas nenit 37 të Kodit penal të Kosovës dhe nenit 147 par. 1, pika. 4, 9 dhe 11 dhe nenit 23, dënohet me burgim të gjatë 25 vjet;

Sipas nenit 154, par. 1, pika.1 dhe 23 të KPK-së dënohet me 3 vjet burgim;

Sipas nenit 291, par. 1 dhe 5 dhe nenit 23 të KPK-së dënohet me 3 vjet burgim.

Sipas nenit 71, par. 1 dhe 2, p.1, 2 të Kodit penal të Kosovës, i akuzuari Shpend Qerimi, **do ta vuajë dënimin me burgim të gjatë 25 vjet.** .

KËRKESA PRONËSORE JURIDIKE

I akuzuari Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi, në mënyrë kumulative dhe bashkarisht, do t'i kompenzojnë palët e dëmtuara Arife Murti, Zyhrije Murti, Guri Murti, Bardh Murti, Avni Murti and Fadil Murti, për dëmet e shkaktuara. Të dhënat e siguruar gjatë procedurës penale nuk sigurojnë bazë të sigurtë për dëmshpërblim ose të plotë ose të pjesërishtëm; gjykata atëherë i udhëzoi palët e dëmtuara të depozitojnë kërkesëpadi civile për tërë kërkesën pronësore juridike sipas nenit 112 (2) të KPPK-së.

SHPENZIMET

Sipas nenit 102 par. 1 të Kodit të Procedurës penale të Kosovës (KPPK) personat e shpallur fajtorë i paguajnë shpenzimet e procedurës. Dispozitat e nenit 100 par. 2 i KPPK-së duhet të përmbushen me aktvendim të posaçëm i cili lëshohet përkitazi shumëve shpenzimeve

ARSYETIM

Rrethanat procedurale

Më 12 gusht 2008, aktakuza kundër tre të akuzuarve u depozitua në gjykatë.

Rasti iu nënshtrua jurisdiksionit të gjyqtarëve të EULEX-it pas vendimit të kryetares së gjykatësve të EULEX-it të datës 5 janar 2009 duke u bazuar në nenin 3 dhe 16.2 të Ligjit 03/L-053 mbi Jurisdiksionin, përzgjedhjen e rasteve dhe alokimin e rasteve gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it, me kusht që “ rasti penal... të mbetet nën autoritetin e gjykatësve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës”.

Seansa e konfirmimit të aktakuzës u mbajt më 2 shkurt 2009.

Gjyqtari i caktuar për dëgjimin e seansës për konfirmim të aktakuzës, me aktvendimin e datës 2 janar 2009, hudhi poshtë pikën 1 të aktakuzës (bashkim kriminal, neni 26.1 i KPPK-së) dhe i konfirmoi tri pikat tjera.

Trupi gjykues në fillim ishte i përbërë nga Z. Bashkim Latifi, Z. Tron Gundersen dhe Z. Franquesko Florit.

Shqyrtimi gjyqësor filloi më 5 maj 2009 por u shtye për javën vijuese pas formaliteteve preliminare (duke përfshirë komunikimin e përbërjes së trupit gjykues dhe verifikimin e ftesave gjyqësore palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve) për shkak të mungësës së të akuzuarve të cilët nuk ishin transportuar në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës nga vendet ku mbaheshin në paraburgim për arsye të cilat pretendohet se ishin të sigurisë.

Me kërkesë të komisionerit të Shërbimit korektues të Kosovës, udhëheqësi i Komponentës së drejtësisë i EULEX-it, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit mbi Jurisdiksionin (të cituar më sipër) mori vendim për ta ndërruar vendin e mbajtjes së gjykimit nga Prishtina në Qendrën për paraburgim të Dubravës (Istog) më 8 maj 2009.

Në seansën e 12 majit 2009, të akuzuarit ishin të pranishëm; pasi u lexua vendimi i udhëheqësit të Komponentës së drejtësisë të EULEX-it për ta ndërruar vendin e mbajtjes së gjykimit, procedura vazhdoi rrjedhën e saj, me identifikimin e të akuzuarve,

paralajmërimet e zakonshme me nenet e KPPK-së që parashihen për të akuzuarit si dhe me leximin e aktakuzës. Pastaj filloi marrja në pyetje e Xh St, V Zt dhe L Nt.

Ne seansat që pasuan, dëshmitarët u dëgjuan me këtë rend.

Më 14 maj 2009 në Qendrën për paraburgim të Dubravës, dëshmitarët e mbrojtur Delta dhe Epsilon si dhe S K.

Më 19 maj 2009, dëshmitari i mbrojtur Një (One), A B dhe M J.

Më 20 maj 2009, dëshmitarët G H dhe B R.

Më 25 maj 2009, dëshmitarët M dhe Z I dhe A A.

Më 28 maj 2009, dëshmitarët e mbrojtur Beta dhe A F.

Më 2 qershor 2009, dëshmitari mbrojtur Gamma, E I dhe S D.

Më 3 qershor 2009, D T.

Më 8 qershor 2009, dëshmitarët H M, I G, A J, F C dhe R B.

Më 9 qershor 2009, dëshmitari F H.

Më 16 qershor 2009, dëshmitari i mbrojtur Zeta dhe F H.

Më 30 qershor 2009, dëshmitarët A A dhe M I u thirrën përsëri para trupit gjykues në mënyrë që të ballafaqohen me regjistrimet e thirrjeve telefonike, përderisa dëshmitari R B u thirr përsëri për t'ia dhënë trupit gjykues disa sqarime.

Më 1 korrik 2009, dëshmitari A T.

Më 2 korrik 2009, dëshmitarët A G dhe R Sh.

Më 17 gusht gjykatësi Bashkim Latifi ia komunikoi gjykatësit kryesues pensionimin e vet dhe, si rrjedhojë e kësaj, pamundësinë që të jetë anëtar i trupit gjykues. Pas kërkesë që iu bë kryetarit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, Znja. Zahide Gjonaj u caktua anëtare e trupit gjykues.

Më 19 gusht 2009, palëve iu komunikua zëvendësimi i gjykatësit vendor dhe ata nuk bënë vërejtje në zbatimin e dispozitës së nenit 345 të KPPK-së. Procesverbal i seansave të mëhershme kështu u lexua për procesverbal. Gjatë të njëjtës seansë, dëshmitari D T u thirr përsëri që të japë disa sqarime mbi përgjimet telefonike.

Më 25 gusht 2009, dëshmitarët R M dhe M A si dhe dëshmitarët e mbrojtur Omega dhe Theta.

Më 26 gusht 2009, nuk u dëgjuan dëshmitarë; trupi gjykues u mor me propozimet e palëve.

Më 2 shtator 2009, dëshmitarët B Sh dhe S S; u fillua me marrjen në pyetje të Besnik Hasanit.

Më 3 shtator 2009, marrja në pyetje vazhdoi me Shpend Qerimin dhe Nusret Cenën.

Gjykata i dëgjoji fjalët përfundimtare të Prokurorit publik, avokatëve mbrojtës dhe të akuzuarive më 16 shtator 2009.

Më në fund, më 22 shtator, trupi gjykues e shpalli aktgjykimin, ua vazhdoi paraburgimin Besnik Hasanit dhe Shpend Qerimit kurse e liroi Nusret Cenën.

Konstatimet ligjore dhe faktike

Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi janë shpallur fajtorë në fund të shqyrtimit gjyqësor i cili, duke pasur parasysh vendin ku është mbajtur si dhe numrin e seansave dëgjimore si dhe numrit të dëshmitarëve, kishte kërkuar përpjekje të konsiderueshme organizimi prej të gjithë pjesëmarrësve.

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, janë bërë të gjitha përpjekjet në mënyrë që të akuzuarve tu sigurohet shkalla më e lartë e garantisë së një gjykimi të drejtë.

Marrja në pyetje e dëshmitarëve ka qenë e lodhshme, ku trupi gjykues ka pasur intervenime të kufizuara përkitazi me përzgjidhjen e pyetjeve të cilat palët i kanë pasur. Procesverbal i seansave, dokumentet prej dhjetëra faqesh secili, e dokumentojnë mirë qasjen të cilën e ka pasur trupi gjykues duke lejuar pyetje pothuajse pa kurrfarë kufizimi. Disa dëshmitarë kyç u desht të dëgjohen për të dytën herë që të japin dëshmi më të hollësishme apo që të ballafaqohen me inçizimet e thirrjeve telefonike. Një numër dëshmitarësh kanë dhënë dëshmi në mënyrë anonime me ndihmën e përkthyesit i cili e fshihte zërin e tyre. Kërkesat e avokatëve mbrojtës për dëshmitarë janë pranuar pothuajse tërësisht.

Në fund të shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka gjetur se ka pasur dëshmi të mjaftueshme për të konstatuar përgjegjësinë e dy prej tre të akuzuarve për faktet që përshkruheshin në aktakuzë, pasi u bë rikualifikimi i pikës së tretë si lëndim i rëndë trupor në vend të tentim vrasjes.

Siç e kanë vërejtur palët gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalët përfundimtare, nuk ka dëshmi direkte në dispozicion të gjykatës përkitazi me kryerjen e krimeve nga të akuzuarit. Është thënë nga avokatët mbrojtës se ‘vetëm’ dëshmitë rrethore janë mbledhur dhe gjinden në lëndë si dhe në procesverbal të gjykimin.

Trupi gjykues vëren se dëshmitë rrethore janë dëshmi të mira. Dhe se shtimi i fjalës ‘vetëm’ nuk i bën drejtësi konceptit të fjalëve ‘dëshmi rrethore’ të cilat e kanë po të njëjtin dinjitet si ‘dëshmitë direkte’.

Të pritet që një rast i ndërlikuar apo një rast ku akuza ka të bëjë me veprim në të cilin ka pasur shumë pjesëmarrës të zgjidhet vetëm në bazë të dëshmive direkte është thjeshtë naive. Mund të jetë pikëpamje e përgjithshme, jo vizion i avokatëve me përvojë, të

mendohet se standardi i kërkuar i aktgjykimit i shprehur në lokucionin ‘fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm’ mund të arrihet, apo ka më shumë gjasa të arrihet, vetëm nëse ka dëshmi direkte për kryerjen e krimit.

Me përjashtime evidente kur marrin pjesë individë jokompetentë apo të çregulluar mentalisht, aktiviteti kriminal nuk kryhet në atë mënyrë me të cilën sigurohen dëshmi direkte.

Përkundrazi, përvoja mëson se shumica e madhe e rasteve penale, në cilin do sistem ligjor dhe në të gjitha vendet, nga ato më primitivet, deri tek ato më komplekset, bazohet në dëshmi rrethore, ku faktet e aktakuzës dëshmohen në mënyrë jo direkte dhe ku kërkohet nga gjykatësi të bëjë deduktime nga faktet e njohura për të përcaktuar se a është e bazuar akuza. Në fund të fundit, ky proces mendor është pjesë kyçe e veprimtarisë gjyqësore si në fushën penale poashtu edhe në atë civile. Vetë fjala ‘jurisprudence’, kur i referohet shkencës së ligjit të futur në praktikë, e dëfton mirë atë ‘prudencë’ (kujdes), d.m.th. vlerësimin e kujdeshëm të fakteve në bazë të rregullave të përvojës, dhe si e tillë ajo përbën esencën e detyrës së gjykatësit. Detyrë kjo e cila kërkon po të njëjtin kujdes të lartë kur paraqiten edhe dëshmi rrethore por edhe kur dëshmitë direkte dalin para gjykatësit.

Zhvlerësimi i pa kritikë i dëshmive rrethore, tek e fundit, është konceptim i gabuar i cili duhet refuzuar.

Kur i nënshtrohen shqyrtimit të hollësishëm dhe kur mirren parasysh rregullat tjera të aktgjykimit të elaboruara në jurisprudencën e përgjithshme në botë dhe në Kosovë (p.sh. gjatë marrjes së vendimit mbi dëshmitë rrethore dhe jo ato direkte, Gjykata duhet të përjashtojë konkludime tjera të mundshme, *Gjykata Supreme e Kosovës, aktvendimi i 21 korrikut 2005, Latif Gashi dhe të tjerët*), dëshmitë rrethore e kanë po të njëjtën shkallë të besueshmërisë si dëshmitë direkte.

Në rastin konkret, dëshmitë rrethore rrjedhin nga një numër i rëndësishëm dëshmish të provuara gjatë zhvillimit të gjykimit e të cilat citohen më poshtë sipas një renditjeje e cila nuk e nënkupton as peshën e tyre relative gjatë vendim-marrjes e as renditjen logjike (renditje kjo në të cilën nuk mund të radhiten faktet me karakteristika të ndryshme e të cilat nuk rrjedhin medoemos si pasojë e njëra tjetrës). Renditja e cila zbatohet këtu është praktike duke u përjekur që faktet të radhiten në njëfarë lloji perspektive.

Para se të fillohet me shqyrtimin e dëshmive relevante për këtë vendim, është e nevojshme të thuhet disa fjalë mbi disa aspekte të gjykimit të cilat nuk mund të kalojnë pa u vënë re për shkak të seriozitetit të tyre dhe pasojave të tyre.

Trupi gjykues e ka fjalën për ndryshimin e vendit të mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe kushteve gjatë dhënjes së dëshmimeve të një numri të madh dëshmitarësh.

Sa i përket çështjes së parë, duhet të na kujtohet se pas një vendimi që e mori udhëheqësi i Komponentës së drejtësisë pranë EULEX-it, z. Alberto Perduka, më 8 maj 2009, në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi jurisdiksonin, përzgjedhjen e lëndëve dhe alokimit të lëndëve gjykatësve të EULEX-it dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji mbi jurisdiksonin), nr. 03/L-053, gjykimi, pas dy seansave të para më 5 dhe 12 maj, në 20 seansat tjera është mbajtur në Qendrën e paraburgimit në Dubravë (Istog).

Kjo ndodhje mjaft e jashtzakonshme (ndryshimi i vendit të shqyrtimit gjyqësor) ishte për shkak të arsyeve të sigurisë, siç u pohua edhe në vendimin e udhëheqësit të Komponentës së drejtësisë. Këtij vendimi i parapriu kërkesa e komisionarit (udhëheqësit) të Shërbimit korektues të Kosovës. Në atë kërkesë ishin shprehur shqetësimet lidhur me rreziqet në lidhje me transportimin e të akuzuarve për në gjykatë si dhe me sigurimin gjatë gjykimit për shkak të profilit të tyre të lartë prej të burgosurish si dhe për lidhjet e tyre të mundshme me rrethin e punës nga i cili vinin. Udhëheqësi i shërbimit korektues i EULEX-it e mbështeti kërkesën për ndryshimin e vendit të gjykimit duke vërejtur se shqetësimet ishin të besueshme.

Kuptohet, trupi gjykues nuk ka për qëllim dhe nuk ka kompetencë që ta komentojë vendimin apo t'i komentojë arsyet të cilat ishin bazë e atij vendimi, por do të përkufizohet në observimin se dëshmitë rrethanore e kanë gjetur konfirmimin e tyre substancial në disa aspekte të dëshmimeve të dhëna nga dëshmitarët.

E tani arrijmë këtu tek pika e dytë e cila u përmend më lartë.

Përveç disa përjashtimeve, secili dëshmitar ka treguar apo shprehur mungesë komoditeti gjatë dhënjes së dëshmisë. Shumë prej tyre kanë qenë dukshëm të frikësuar të flasin, shumë kanë denoncuar kërcënime. Për dëshmitarët të cilëve u ishte miratuar anonimiteti gjatë hetimeve, nuk mjaftonte që të mbaheshin në një dhomë të veçantë dhe tu mbahej identiteti i pazbuluar: ka qenë e nevojshme të gjindet një sistem i cili nuk ua mundësonte publikut dhe palëve ta dëgjojnë zërin e dëshmitarit.

Në një rast, dëshmitari ka qenë aq i frikësuar të flasë (dëshmitari Zeta, i cili ka dhënë dëshmi lidhur me arritjen e dy kerreve të policisë në vendin a ngjarjes) sa që ka refuzuar të flasë ditën kur është ftuar dhe sjellur në gjykatë (20 maj); dëshmia e tij është dashur të shtyhet për datën tjetër vijuese (16 qershor) meqë ka pranuar të japë dëshminë e tij para gjykatës në mënyrë anonime vetëm atëherë kur i ishte miratuar skE e EULEX-it për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Në vijë të njëjtë, në një numër të dukshëm rastesh, dëshmitarët kanë treguar druajtje dhe ngurrim të flasin ose tendencë që të japin përgjigje të pakapshme dhe bishtnuese. Për këtë arsye, është dashur që të ballafaqohen (neni 364 i KPPK-së) me deklaratat e tyre të mëhershme të dhëna para prokurorit. Ka qenë përvojë poshtëruese për të parë se kjo ka ndodhur gjithashtu disa herë kur ata që ishin të ulur në bankën e dëshmitarëve ishin policë (M J, Alban Jetullahu, Isag Gashi *in primis*).

Në një rast tjetër, dëshmitari (A B) erdhi në gjykatë duke pretenduar që tu përgjigjet vetëm pyetjeve që kishin të bënin me rastin e “tij”, do të thotë me hetimet në rastin e vrasjes së tre të afërmëve të tij, që kishin lidhje me këtë rast por që ishte rast tjetër prej rastit konkret, siç do të ceket më vonë.¹

Në të njëjtën vijë, duhet të shtohet se mosbesimi në rolin, funksionin dhe detyrat e dëshmitarëve, duket të kenë ndikuar ngadonjëherë në po të njëjtit avokatë mbrojtës të cilët, kur ballafaqoheshin me dëshmi të cilat nuk u shkonin në favor klientëve të tyre dhe duke mos pasur argumente tjera që ta kontestojnë dëshminë apo besueshmërinë e dëshmitarit, përdornin pyetje përkitazi me arsyet e dëshmitarit për të dhënë dëshmi dhe me atë se kush dhe për çfarë arsye i kishte ftuar ata.²

Në fund, këngëtarja që supozon të jetë e popullarizuar në Kosovë, A I, ka refuzuar të vijë në gjykatë që të japë dëshmi me arsyetim të rrejshëm se kishte angazhime më të rëndësishme jashtë vendit. Gjatë përpjekjeve që ishin bërë për të marrë dëshminë e saj në gjykatë, ishte e nevojshme jo vetëm që ajo të ftohet në vende të ndryshme ku ajo banonte, por edhe të kontaktohet në telefonin e saj mobil. Zyrtarit juridik, i cili kishte folur me të dhe nënën e saj, i ishte premtuar se do të jetë e pranishme në gjykatë. Ajo nuk erdhi kurrë që të japë dëshminë e saj dhe deklarata e saj që ishte dhënë në Prokurori si dhe hetuesve gjatë hetimeve u fut në procesverbal si e lexuar sipas nenit 368, par. 1, numri 1.³

Ky lloj sjelljesh i dëshmitarëve si dhe të denoncuarit e frikës apo të kërcënimeve kanë qenë të tipike gjatë gjykimit.

Arsyet?

¹ A B: Para se të vdesë ai (i afërmi i tij Neshat Baftiu, i vrasë më 27 shtator 2009) ka thënë shumë gjëra dhe se atë që e ka thënë për rastin ma ka thënë jo vetëm mua por edhe publikisht. Kam menduar se më kanë ftuar këtu të flas për rastin tim e për atë rast do të flas, por për rastin e njerëzve tjerë, nuk kam çka të them.

Gjykatësi kryesues: Duhet të përgjigjeni, është përgjegjësi e juaja dhe se dëshmitari nuk mund të thotë se a përgjigjet apo jo.

A B: Përsëri, po them se lidhur me njerëzit e mi mund të përgjigjem, por se sa njerëz vriten rreth e rrotull nuk mund të përgjigjem.

Presiding Judge: Nëse e dini, thone, dhe nëse jo, mos e thone. Dëgjoni pyetjet e pastaj flisni.

Prokurori publik: Çfarë të kishte thënë Neshat Baftiu për shpërthimin me bombë në Bulveradin Bill Clinton?

A B: Ai person nuk është gjallë kështu që deklarata nuk është e gjallë dhe nuk mund të dëshmohet(Gjykatësi kryesues e ndërpreu)

Gjykatësi kryesues: Nuk po kërkojmë që ta dëshmoni, por vetëm të thoni se çka është thënë.

A B: Po ju kuptoj por ju nuk po më kuptoni mua, nuk kam çka të them për këtë rast. Prokurori publik: Do ju pyes përsëri. I keni thënë policisë se çfarë të kishte thënë kushëriri i juaj para se ai të vdiste dhe po ju kërkoj që t'i thoni gjykatës se çka të kishte thënë Neshat Baftiu lidhur me shpërthimin me bombë?

A B: Nuk kam çka të them sot. I kam thënë policisë se do të japë deklaratë vetëm në rastin tim.

...A B: Ju thash, mos më pyetni për eksplozim se nuk do të them asgjë lidhur me të.

Në fund, A B thotë: “Do të jap përgjigje për fjalët e mia, nëse ato kanë të bëjnë me rastin e familjes sime”... “Nuk kam përgjigje lidhur me eksplozimin”.

² Marrja në pyetje dëshmitarëve Omega dhe Theta, procesverbal i 25 gushtit 2009, seansa e pasditës.

³ Vendimi i trupit gjykues, shqyrtimi i 26 gushtit 2009, fq. 4 e procesverbalit

Ngadonjëherë ishte ‘kultura e frikës në mesin e dëshmitarëve’ siç e ka cekur në mënyrë korekte edhe prokurori⁴ dhe kjo qartë ka të bëjë me ata dëshmitarë të cilit ishin të mbrojtur (dëshmitarët e vendit të ngjarjes, dëshmitarët Omega dhe Theta, M I).

Por ngadonjëherë ishte ‘*omerta*’ (fjalë kjo italiane e njohur botërisht), d.m.th. kodi i heshtjes nga ana e atyre të cilët i takojnë të njëjtit rreth apo janë të lidhur me të akuzuarit me punë (F C, policët) apo lidhje familjare (F C dhe S S); apo kanë interes i cili në një farë mënyrë apo tjetër është në konflikt me detyrën për ta thënë të vërtetën (Baftiu, A I).

Ngadonjëherë ishte thjeshtë mungesë respekti dhe besimi në rolin e gjykatave në Kosovë.

Këto situata duhet ceken sepse ato kanë pasur ndikim në rrjedhën e tërë gjykimit në atë masë sa që anëtarët e trupit gjykues nuk e kishin hasur më herët si përvojë në Kosovë apo jashtë.

Njerëzit të cilët i përkisnin sektorëve të ndryshëm të shoqërisë e që nuk ishin të lidhur me njëri tjetrin e të cilit nuk kishin lidhje direkte me të akuzuarit kanë denoncuar kërcënime reale apo të perceptuara apo rreziqe ndaj integritetit të tyre personal nga fakti se kanë qenë të caktuar si dëshmitarë të këtij gjykimi.

Kjo mënyrë e të dëshmuarit ka qenë aq flagrante dhe e përsëritshme sa që përbën vetvetiu parametër për vlerësimin e dëshmimeve të dëshmitarëve, siç edhe do të ceket më specifikisht më vonë.

Tani mund të përqëndrohemi në faktet të cilat janë dëshmi rrethore të rastit.

Gjatë shqyrtimit të fakteve, trupi gjykues mendon se nuk është e nevojshme të ilustronet në fillim dhe në hollësi skenari i gjerë i ngjarjeve të cilat i kanë paraprirë fakteve të përshkruara në aktakuzë e të cilat, sipas perspektivës të cilën e kishte prokurori, përbëjnë motivin i cili e kishte inicuar aktin kriminal të 24 shtatorit 2007. Për arsye të shkurtimit dhe me qëllim që ky vendim të bëhet më i lehtë për tu lexuar, mendojmë që duke filluar *in media res* është qasje më e mirë.

Dëshmitë rrethore të gjykimit mund të përmbliohen në këtë mënyrë:

1. Provat e shpërthimit dhe rrethanat përreth;
2. Informatat që vijnë nga M I (fq 15);
3. Informatat në lidhje me vrasjen e Neshat Baftiut dhe dy të tjerëve (fq. 21);
4. Përgjimet telefonike dhe dëshmi tjera teknike (fq. 31);
5. Alibi i të akuzuarve (fq. 40).

1. Provat e shpërthimit dhe rrethanat përreth

Trupi gjykues i dëgjoji disa dëshmitarë përkitazi me shpërthimin që kishte shkaktuar vdekjen e Naim Murtit dhe Pleurat Sllamnikut, lëndime të rënda Xh St, V Zt, L Nt, G S,

⁴ Fjala përfundimtare e prokurorit, dokumenti i shkruar, faqja 1

E St, N Ht, F B, L K, Sh S, Milot Kadriut dhe Teuta Kadriut si dhe dëmë të mëdha materiale.

Dëshmitarët ishin klientë (Xh S, V Z, L N, dëshmitarët Beta, Delta, Epsilon dhe Gamma) të bar-kafesë 'Pasasage' i cili gjindej në të njëjtin objekt ku ndodhi shpërthimi dhe i cili i shkatërrua nga shpërthimi, apo ishin aty afër vendit të ngjarjes për shkak të punës (dëshmitarët Hesat Hydari, dëshmitarët Një (One), Gamma dhe Zeta).

Deklaratat e tyre në gjykatë japin përshkrim homogjen të ngjarjeve me shumë pak divergjenca.

Ata në mjaft detaje e përshkruajnë arritjen e grupit të personave që dukeshin se i takonin forcave të policisë, të veshur në uniforma të policisë speciale me xhaketa antiplumb e që kishin maska. Detajet që u përsëritën gjatë dëshmive të ndryshme kanë të bëjnë me një lloj të veçantë arme të cilën disa pjesëtarë të grupit e kishin mbajtur (përmendej në mënyra të ndryshme si MP5, Shkorpion apo UZI, d.m.th. mitraljoz i shkurtër dhe kompakt) si dhe me një parë dana të kuqe, të gjata 70 cm deri 1 m.

Trupi gjykues e ka ndier që nuk është i nevojshëm përshkrimi i hollësishëm i fakteve duke pasur parasysh homogjenezitetin e deklaratave mbi modalitetet e veprimeve si dhe numrin e dëshmive që përkonin njëra me tjetrën sa i përket kësaj pike. Të njëjtit avokatë mbrojtës kryesisht nuk e kanë kontestuar besueshmërinë e dëshmitarëve gjatë seansave apo gjatë fjalëve përfundimtare . Është e vërtetë se avokatët mbrojtës, gjatë seansës së parë në të cilën u dëgjuan dëshmitarët e vendit të ngjarjes, u përpoqën t'i kontestojnë deklaratat e tyre duke pyetur, për shembull, se cilat ishin kushtet e dukshmërisë në kohën e ngjarjes (rreth orës 2 të natës) apo kushtet e ndriçimit në pikën ku gjindeshin dëshmitarët në momentin kur e panë atë grup të personave; por këto përpjekje nuk zgjatën shumë dhe nuk u insistua në to, në fakt, meqë u pa shumë shpejtë se dëshmitarët mund të shihnin qartë se çfarë kishte ndodhur jo më pak nga konteksti se sa nga numri i detajeve që u dhanë e të cilat u përsëritën në deklaratat e ndryshme. Ishte evidente që prania e lëvizjeve të një grupi individësh të koordinuar mirë, të cilët lëviznin dhe vepronin si policë të trajnuar në aksion, dëshmitarëve ua kishte tërhequr vëmendjen dhe i kishte shokuar dhe frikësuar duke kontribuar kështu që kujtesa e atyre ngjarjeve të konsolidohet qartë. Kështu ngjau pak kohë më pas kur avokatët mbrojtës dhe vetë të akuzuarit i ndalën komentet dhe kundërshtimet ndaj dëshmive të atij grupi të dëshmitarëve. Po në të njëjtën mënyrë u zbeh edhe interesimi të cilin ata e kishin në fillim për t'iu bërë pyetje dëshmitarëve dhe shihej gjithnjë e më shumë se përpjekjet e tilla bëheshin të kota në krahasim me soliditetin e deklaratave të tyre. Në disa raste të rralla, megjithatë, shtruarja e pyetjeve për këtë grup dëshmitarësh shkoi aq larg sa të testohet besueshmëria e dëshmitarëve apo aftësia e tyre e të mbajtur mend si duhet. Por rezultati ishte i pamjaftueshëm dhe kishte si pasoi që të zvogëlohet besueshmëria e konstestimit e jo ajo e deklaratës.

Për shembull, nga dëshmitarët u kërkua në fillim që të përshkruajnë në hollësi kushtet e dukshmërisë dhe distanca në mes tyre dhe grupit të personave që ishin me uniforma të policisë speciale; atyre iu bë pyetja që të thonë në mënyrë specifike se a kishte televizion në bar-kafenë Passage si dhe të thonë se si ishte e mundur të shihet dhe duket qartë lëvizja e grupit nëse televizioni ishte i ndezur; dëshmitarët u kundërshtuan në atë se, duke pasur parasysh pozitën e tyre në bar-kafene, nuk ishte e mundur të shihej jashtë; një

dëshmitar u pyet se mos iu kishte përzier kujtesa e kerreve të policisë në parkingun prapa objektit para shpërthimit me kerret e policisë që kishin arritur në vendin e ngjarjes pas shpërthimit... Realisht, në të gjitha këto vërejtje, dëshmitarët e ndryshëm u përgjigjen saktë, pa ngurrim dhe me vendosmëri; ata kurrë nuk treguan konfuzion; në të kundërtën, ata ngadonjëherë befashoheshin bile edhe iritoheshin në pyetje të tilla.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër, gjykata gjen se nuk është e nevojshme të raportohen në mënyrë analitike deklaratat e njëmbëdhjetë dëshmitarëve të vendit të ngjarjes. Një përmbledhje e shkurtër e tyre duket të jetë e mjaftueshme.

Nga dëshmitë e ndryshme rezulton se në natën e ngjarjeve, më saktësisht në orët e para (kah ora 2 e mëngjezit) të 24 shtatorit 2007, dy policë kishin hyrë në parkingun prapa objektit ku kishte ndodhur shpërthimi; një grup prej pesë personave të veshur në uniforma të policisë speciale dhe një tjetër i cili kishte të veshur një bluzë të kuqë (gjithsejtë gjashtë persona) kishin dalë prej kerreve dhe lëvizur nga parkingu nëpër koridorin i cilin çon në Bulevardin Bill Klinton, duke kaluar para bar-kafesë Passage; grupi ishte kthyer në parking pas pak dhe dikund dhjetë minuta më vonë kishte ndodhur eksplodimi.

Çfarë mund të konkludohet nga informatat e dëshmitarëve?

- a) se pjesëtarë të forcave të policisë ishin të involvuara dhe kishin kryer aktin kriminal

Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve, avokati mbrojtës në fillim u përpoq të kontestojë duke thënë se dhënësi i dëshmisë kishte parë persona të veshur në uniforma të policisë, e jo policë¹ si dhe kerre identike me ato që i përdorë policia, por jo medoemos kerre të policisë. Kjo u bë me qëllim që të sygjerohet që i tërë aksioni ka mundur të jetë i inskenuar nga një grup i organizuar kriminelësh të cilët dëshironin që policia të fajësohet për krimet e tyre (do të thotë të kriminelëve). Kjo teori ‘komploti’, e mirë ndoshta për një komplot filmi, nuk është bindëse. Jo vetëm sepse një gjë e tillë do të kërkonte përpjekje të jashtëzakonshme organizimi, gjë e cila pothuajse nuk do të mund të mbahej sekret në rrethin e kriminelëve nga ka rrjedhur, por sepse thjeshtë ajo ka pak kuptim. Pse të fajësojet policia kur planifikohet një aksion të tillë shkatërrues? Në të kundërtën, përdorimi i kerreve të cilat ishin lehtë të identifikueshme si dhe i uniformave të forcës speciale është si një lloj vule, një ‘*imprimatur*’ për një veprim i cili, për karakteristikat e veta (shkatërrimi i restorantit Sekiraqa) ka qenë paralajmërim, shenjë për viktimën – ‘ne mund të godasim ty në çfarëdo kohe’.

Dëshmitarët saktësisht i kanë përshkruar aspektet e kerreve (ngjyrat, tipi, shenjat e ‘Policisë’, grilat mbrojtës në drita, dritat e alarmit mbi kulmin e kerreve) si dhe pjesëtarët e grupit (përfshirë aty armët dhe rrobat) gjë që peshon në dobi të autenticitetit dhe origjinalitetit të tyre.

Si konkludim, sygjerimi që dikush i cili nuk u takon forcave të policisë mund të ketë organizuar sulmin në restorantin Sekiraqa nuk ka kuptim dhe duhet të shpërfilllet si supozim i thjeshtë defanziv, i zbrazët dhe pabazë.

¹ P.sh. Avokati Avni Ibrahim, procesverbali i deklaratës së dëshmitarit V Z, 12.05.09, fq. 11

Ata të cilët e kanë planifikuar dhe ekzekutuar veprën penale kundër Enver Sekiraqës dhe pronës së tij kanë qenë policë. Në bazë të modaliteteve që janë përdorur, nuk mjafton të thuhet se nuk janë kujdesur që të jenë të identifikueshëm gjatë aksionit. Është më korekte të thuhet se ata në fakt kanë dashur të identifikohen si policë. Për të arritur qëllimin e tyre, d.m.th. për të dërguar mesazh të qartë frikësimi, ata është dashur që ta bëjnë vetëm të identifikueshëm si policë. Aksioni me karakteristikat e veta nuk është akt hakmarrjeje (ose nuk është vetëm hakmarrje), ai është akt frikësimi. Hakmarrja (për vrasjen e Triumf Rizës me urdhër të Enver Sekiraqës, siç është supozuar nga prokurori) do të kishte qenë shumë më direkte dhe do t'ishte ekzekutuar në mënyrë më të fokusuar. Çak do të kishte qenë vetë Sekiraqa apo dikush prej të afërmeve të tij. Ekzekutuimi i hakmarrjes, në këto kushte, nuk do t'ishte bërë *en plein air*² por më me shumë kujdes. Nuk do t'ishte e kuptimtë që një mjet shpërthyes të vendoset jashtë një restorani të zbrazët për të marr hak për vrasjen e një kolegu. Shpërthimi i bombës ka qenë më tepër akt frikësimi, signal të cilin do ta kuptonte lehtë Sekiraqa i cili, duke supozuar se ka qenë në arrati, do e kishte perceptuar nga vendi i tij ku fshihej si një rrezik për tu kthyer në Prishtinë apo Ferizaj.

Marrja e hakut shikon në të kaluarën; ajo paraqet ndëshkim për ndonjë vepër apo krim. Ajo e mbyll rrethin, ajo nënkupton dhe pretendon ta ri-vendosë rendin dhe 'drejtësinë'. Në anën tjetër, frikësimi shikon kah e ardhmja, ai bëhet me qëllim që të ndikohet në sjelljet e ardhshme, ai pretendon dhe nënkupton vendosjen e një serie të re rregullash, apo role të reja, me anë të së cilave frikësuesi pret që viktima ta respektojë. Nga kjo rrjedh se ai i cili e kryen frikësimin ka interes që viktima e tij/e saj ta kuptojë prej nga vie ai frikësim. Kjo e justifikon përdorimin haptazi të kerreve të policisë dhe të rrobave policore. Me këtë shpjegohet pse grupi kishte kaluar pa e çarë kokën para klientëve të bar-kafesë 'Passage' (shtegu nga parkingu prapa objektit që çon përpara, ku shkallët çojnë në restorantin Sekiraqa, është vetëm disa metra i gjerë).

Ekziston edhe një konkludim tjetër i cili mund të nxirret nga modalitetet e aksionit. Nëse frikësimi është kyç për motivin e aktit kriminal, ata të cilët e planifikuan atë e kanë ditur se viktima e tyre (Enver Sekiraqa) do ta kuptonte nga cili seksion apo grup brenda policisë së Kosovës vjen kërcënimi. Nuk do të kishte aty vend për mëdyshje. Sekiraqa do të dyshonte në vetëm një numër të kufizuar njerëzish.

b) se numri i të dyshuarve të mundshëm është i kufizuar

Kjo është mjaftë e dukshme. Në mesin e mijëra policeve dhe policëve të Kosovës, policë këta të cilët meritojnë respektin më të lartë për aktivitetet e tyre të përditshme dhe për rreziqet e vështirësitë me të cilat ballafaqohen, vetëm disa persona janë përgjegjës për aktin në Bulevardin Klinton. Kah të drejtohen hetimet atëherë? A është e arsyeshme të bëhet ekzaminimi i secilit polic, për shembull nga Prizreni apo Peja? A është e arsyeshme të hetohen të gjitha marrëdhënjet e mundshme të Enver Sekiraqës (akti kriminal kishte cak evident pronën e tij dhe atë vetë) për të zbuluar arsyet eventuale të hakmarrjes kundër tij, përkundër faktit se akti rridhte prej një grupi policësh të cilin kishin devijuar? Avokatët mbrojtës kanë bërë vërejtje disa herë, ngadonjëherë me ndjenja të forta kundërshtimi, duke e konstestuar lirinë e Prokurorit për të paragjykuar¹ si dhe duke e

² Nga frengjishtja "haptazi" shënim i përkthyesit

¹ Seansa e 14 majit 2009, komentet e z. Durak Jashari, fq 25 dhe 31, në mesin e shumë fragmenteve.

kontestuar besueshmërinë² e disa dëshmitarëve, se hetimet u drejtuan menjëherë në drejtim të të akuzuarve e nuk u hapën edhe ndaj të dyshuarve tjerë të mundshëm. Kjo është cekur si një prej dështimeve kryesore të hetimeve.

Sa i përket kësaj pike, trupi gjykues vëren se nuk ka shkelje apo moskujdes në hetime, për dy arsye.

Së pari, do të kishte qenë gabim, nga pikëpamja e hetuesisë, të shpenzohen burime dhe kohë, duke filluar me hetime të verbëta, d.m.th. pa drejtim të qartë. Duke pasur parasysh prezencën e indikatorëve makroskopikë lidhur me përfshirjen e policëve, policë, do t'ishte neglizhencë nëse nuk do të përqendrohej në gjurmët që ishin në dispozicion.

Së dyti, dëshmitë të cilat gjykata i ka në dispozicion duhet të vlerësohen në bazë të asaj se çka paraqesin ato. Nëse ka dëshmi të mjaftueshme për ta bazuar fajësinë, rrethana se mund të ketë pasur drejtime tjera të hetimeve është irelevante, meqë ato drejtime të mundshme, të mira në teori *ex ante*, bëhen vetëm spekulime të gabuara *ex post*. Është e detyrë dhe përgjegjësi e prokurorit të bëjë seleksionimin në mënyrë që t'i drejtojë hetimet në drejtim frytdhënës. Detyra e prokurorit për të bërë hetime të rrethanave që janë në favor të të akuzuarve si dhe të atyre që janë kundër tyre (pikë kjo tjetër që është ngritur nga avokatët mbrojtës në një fazë të procedurës) është detyrë tjetër dhe e ndryshme (neni 7 i KPPPK-së) e cila mund të paraqitet vetëm atëherë kur të jetë caktuar drejtimi i hetimeve. Dhe kjo është detyrë e cila është kusht kur ka fakte të cilat me të vërtetë ekzistojnë në favor të pandehurve apo të cilat mund të supozohen në mënyrë të arsyeshme. Nëse ato fakto nuk ekzistojnë apo nuk i sillen në vëmendje hetuesit, si mund të kryhen hetime ndaj tyre.

Atëhere bëhet e qartë se numri i kandidatëve potencial të cilët mund të kenë cilësinë e të dyshuarve duhet mëtutjje të kufizohet në ata policë të cilët mund të kenë pasur arsye të urrejtjes kundër caktuar dhe viktimës së krimit, Enver Sekiraqës.

c) se akti nuk ka qenë i drejtuar për të vrarë Enver Sekiraqën

Kryesit e aktit nuk kanë mundur të mos e dinë se Enver Sekiraqa nuk ishte në restorantin e tij në natën e 24 shtatorit dhe se restorani ishte i mbyllur. Rrethana se Sekiraqa fshehej pasi që kishte ndodhur vrasja Triumf Rizës sepse kërkohet nga forcat e policisë së Kosovës ishte e njohur për çdokënd¹.

d) se akti i grupit të policëve ka qenë i planifikuar mirë përpara

Të mbledhësh një numër prej gjashtë individësh, t'i bindësh për nevojën se duhet goditur viktima e caktuar, ta mendosh një lloj mesazhi apo përgjigje që duhet dërguar atij, ta

² Marrja në pyetje e dëshmitarëve Fulco dhe D'Orsi, seansa e 28 majit dhe 2 qershorit 2009

¹ Dë Esat Hydary, procesverbali i seansës së 12 majit 2009, fq. 21, dëshmitari Selajdin Kamishi, seansa e 14 majit 2009, fa. 29

kryesh një krim në mënyrë aq bombastike, ta gjesh mjetin shpërthyes dhe t'i studiosh modalitetet e aksionit, duhet kohë. Një gjë e tillë kërkon vështirimin e vendeve dhe kohës për kryerjen a aksionit. Për shembull, rrethana se ata kishin marrë me vete një palë dana tregon se ata e dinin se duhej me forcë ta thyenin rezistencën e derës e cila ishte mbyllur². Kryesit, me përvojën e tyre të policisë, nuk ishin naiv apo të pashkathët; është evidente te konkludohet se duhet t'i kenë pasur parasysht të gjitha aspektet dhe opsionet e aksionit të tyre.

Vetëm rezistenca e derës të cilën kryesit nuk arritën ta thejnë i ka bërë ata që ta ndryshojnë planin dhe ta vendosin mjetin shpërthyes nën shkallë¹, me qëllim që fuqia e shpërthimit të mos zvogëlohet nga hapësira e hyrjes në restorant.

2. Informatat e dhëna të M It

T'i kthehem tani dëshmive rrethimore që vijnë nga deklaratat e M It dhe nga dëshmitë të cilat ajo i kishte dhënë gjatë hetimeve.

Dëshmitarja është paraqitur në gjykatë më 25 maj 2009 si dëshmitar i mbrojtur X. Në fillim të marrjes së saj në pyetje, megjithatë, ajo hoqi dorë nga anonimiteti dhe nga mundësia që të përgjigjet në pyetje nga një dhomë veç dhe me zë të fshehur. Ashtu siç u paralajmërua edhe nga një prej avokatëve në gjykatës, znja. M I e refuzoi të jetë dëshmitare e mbrojtur, një gjë të cilën e kishte pasur më herët dhe u paraqit haptazi para trupit gjykues në sallën e gjykimit.

Dëshmia e saj ishte me mjaft kontraste. Ajo shfaqti zhgënjimin e saj të flasë, duke i kontestuar rrethanat me evidente, duke dëshmuar se ishte gabim ajo çfarë po e pyeste prokurori dhe kur ky po e ballafaqonte me deklaratat e saj të mëhershme të dhëna gjatë hetimeve. Duke hequr dorë nga anonimiteti, ajo e fajësonte shtypin dhe prokurorin ndërkombëtar (të UNMIK-ut)² sepse e kishin bërë publike deklaratën e saj dhënë në hetuesi. Ajo dukej t'ishte qartë e shqetësuar nga prania e të akuzuarve, të cilëve disa herë iu ishte referuar me fjalën 'bala' (katunarë, fshatarë). Ajo në mënyrë rrënjësore i kontestoi deklaratat e saj të mëhershme, duke pohuar se (i) ajo nuk dinte /kuptonte asgjë, (ii) se kishte pasur problem me përkthim/ajo kishte qenë tej mase e lodhur/ nën presion kur ishte marrë në pyetje dhe se nuk i kishte lexuar deklaratat që i kishte nënshkruar, (iii) se qëllimi i saj i vetëm 'ishte t'i heqë qafe këta njerëz' meqë 'pas vrasjes së policit jeta më është bërë ferr, dhe se nuk doja që këta "bala" të më vijnë në shtëpi"(seansa e 25 majit 2009, fq. 7).

² Dera mund të shihet në fotografitë n. 139 dhe 166 në vëllimin 11.

¹ Raporti i KFOR-it nga vendi i ngjarjes i datës 24.09.07, vo. 8, fq. 2184; dëshmitari Fulco, 28 maj 2009, fq. 17. Fotografitë nr. 145 dhe vazhdimi I vol. 11.

² përkritazi me këtë pikë, prokurori i EULEX-it u përgjigj që, ishte e kundërta, prokurori ndërkombëtar kishte kërkuar masa mbrojtëse për atë (fq. 6)

Trupi gjykues ka vërejtur, gjatë marrjes së saj në pyetje, se vendimi i dëshmitares që të heqë dorë nga mbrojtja të cilën më herët ia kishte akorduar gjykata ishte mjaft i jashtëzakonshëm (fq. 6).

Më vonë (fq. 13), për arsye të shumë mospërputhjeve në mes të versionit të dhënë në gjykatë dhe deklaratës së dhënë para prokurorit më 14 dhjetor 2007, gjykatësi kryesues është dashur ta ballafaqojë dëshmitaren sipas nenit 364 (KPPPK-së), duke ia lexuar asaj fragmentet relevante të deklaratës së saj të mëhershme.

Znja. M I ka pohuar se në kundërshtim me deklaratat e saj të mëhershme, ajo kurrë nuk ishte kërcënuar nga askush. Asaj i kujtohej prania e Besnik Hasanit, Shpend Qerimit dhe Nusret Cenës në banesën e saj disa ditë përpara shpërthimit por e ka kontestuar se është biseduar lidhur me Enver Sekiraqën. Ajo e ka konstestuar t'i ketë dërguar sms Faton Shoshit natën kritike por e ka pranuar se pseudonimi të cilin ajo dhe Faton Shoshi e përdornin për Besnik Hasanin ishte "Vëllai" apo "B.H."ose Besnik Firaja (në bazë të fshatit nga vinte Besnik Hasani). Ajo e ka konfirmuar pakënaqësinë e saj për vizitat që tre të akuzuarit e kishin bërë në banesën e saj si dhe për lidhjet e njëres prej vajzave të saj Adelinës) me Besnik Hasanin. Kur iu lexua asaj deklarata e 14 dhjetorit 2007 dhënë prokurorit, ajo e kontestoi atë që e kishte thënë, me arsyetimin: "Kam dasht vetëm t'i he qafe këta njerëz (seansa 25 maj 2009, fq. 14).

Në mënyrë që të vlerësohet besueshmëria e dëshmisë së dëshmitares dhënë në gjykatë, dhe që të krahasohet ajo me deklaratat të cilat më herët ia ka dhënë prokurorit (më e rëndësishmja është ajo e datës 14 dhjetor 2007), duhet të mirret së pari parasysh sjellja e saj në gjykatë.

Motivet që i ka dhënë M I për ndryshimin e deklaratës që u citua me sipër janë kundërthënëse dhe jo të besueshme. Dy të parat (ajo nuk dinte asgjë – ka qenë nën presion dhe e hutuar gjatë hetimeve që i bënte prokurori) janë justifikime të zakonshme të cilat dëshmitarët i japin në sallë të gjykimit kur dëshirojnë t'i ikin detyrës për të dhënë dëshmi para publikut. Çfarëdo që të jetë arsyea (kërcënim, turp, ndryshimi i kushteve, premtimi për ndonjë beneficion), të fajësosh hetuesit apo prokurorin (apo përkthyesit të cilët i asistojnë ata) për shkelje gjatë marrjes në pyetje është një pretekst që përsëritet çdo herë. Të njëjtat pretekste i kanë përdorur edhe dëshmitarët tjerë të këtij gjykimi (G H, A B, M J, për të përmendur disa).

Nuk është vështirë t'i rrëzosh poshtë argumentet të cilat i cek dëshmitarja.

Se M I dinte pak, ashtu siç pretendon, nuk është e vërtetë: ajo ishte në gjendje të japë detaje specifike të cilat as vetë e njëjta prokurore nuk ka mundur t'i dijë rreth ngjarjeve. Për shembull, ajo e ka sqaruar kuptimin e shprehjes 'do t'i shfarosim edhe minjtë në tavan', duke sygjëruar se e kishtë dëgjuar këtë nga tre të akuzuarit gjatë vizitës që ia kishin bërë vajzës së saj. Më tutje, ajo i ka treguar prokurorit për praninë e të akuzuarve në shtëpinë e saj disa ditë para shpërthimit, rrethanë kjo që ishte e panjohur për hetuesit por që më vonë u konfirmua nga i njëjti Besnik Hasani gjatë marrjes së tij në pyetje nga ana e prokurorit¹. Në fund, ajo i identifikoi tre të akuzuarit dhe kontribuoi që të zbulohet

¹ Rrethana u konfirmua në mënyrë të pakontestueshme nga mesazhet të cilat M I ia kishte Faton Shoshit dhe Besnik Hasanit më 23 shtator 2007 në ora 1:55 të mëngjezit dhe 10:15 dhe nga hartografia telefonike

identiteti i Nusret Cenës (gjatë vizitës në restorantin Europa '92, dhe në bashëpunim me vajzën e saj A In e cila ishte me të në atë moment.

Se ajo e ka dhënë deklaratën e saj para prokurores vetëm sa për t'i hequr qafe të tre të akuzuarit, nuk është e vërtetë as kjo.

T'i marrim parasysh mesazhet e shkëmbyera në mes të Faton Shoshit (të fejuarit të vajzës së Monës¹, Z It – dhe ithtar i Enver Sekiraqës) në natën e 24 shtatorit 2007 në orët e para të mëngjezit, përafërsisht 20 minuta pasi që kishte ndodhur shpërthimi në Bulevradin Bill Klinton.

Përmbajtja e mesazheve të dërguara njëra pas tjetrës shihet nga regjistrimi i thirrjeve telefonike². Në mesazhin e parë të cilin M ia dërgon Fatonit në ora 2:39 të mëngjezit të 24 shtatorit 2007, lexojmë “i vëllai me shokë kanë vu dinamitin, o Zot, o Zot”³. Përgjigja e dërguar brenda disa sekundave thotë: “Kush të tregoi? A, a, a”. Përsëri znja. I përgjigjet, në ora 2:42 të mëngjezit: “I kam dëgjuar mbrama duke thënë se do t'i shfarosin edhe minjtë në tavan!”.

Nëse thellohem në tekstet e dy mesazheve, është evidente se shkëmbimi i tyre nuk kishte për qëllim, siç e thoshte M gjatë dëshmisë së saj të 25 majit 2009, t'i heqë qafe tre të akuzuarit të cilët, sipas verzionit të saj, po e trazonin atë dhe vajzat e saj. Nuk është argument i qëndrueshëm që 20 minuta pasi që kishte ndodhur ngjarja, seriozitetin e së cilës dëshmitarja e kishte kuptuar dukshëm pa pasur bile as nevojë që ta vizitojë vendin e ngjarjes apo ta dijë se çfarë kishte ndodhur më të vërtetë, ajo e kishte menduar që ta shfrytëzojë rastin t'i fajësojë tre njerëz të pafajshëm për një akt me përmasa të tilla. Ideja që mesazhet ishin montim i drejtuar kundër të akuzuarve është qesharake meqë M I nuk ka mundur të jetë në dijeni e as që ka mundur ta marr me mend se telefoni i Faton Shoshit po përgjohej dhe regjistrohej për shkak të përfshirjes së tij të supozuar në një rast tjetër (vrasja e Triumf Rizës).

Gjithashtu edhe po ta kishte ditur, nuk është e qartë pse vetëm pak pasi e kishte dëgjuar shpërthimin, ajo mori iniciativën t'i heqë qafe tre të akuzuarit. Nuk ka gjurmë në dosje se para natës 24 shkurtit 2007 ajo ishte përpjekut t'i diskreditojë apo të bëjë diç tjetër për të parandaluar gjoja ndërhyrjeën e tre të akuzuarive në jetën e saj dhe të tri vajzave të saja. Përkundrazi, vetëm pak pas ngjarjes, ajo i kishte aktivizuar kamerat jashtë shtëpisë së saj⁴.

Për më tepër, nëpërmjet mesazheve që u dërguan natën e shpërthimit, shihet se dëshmitarja e ka ditur rrethanën (planifikimin për bombë të bërë nga Besnik Hasani dhe bashkëpjesëmarrësit e tij) të cilën e kishte konfirmuar në deklaratën e saj të 14 dhjetorit 2007. Ajo kishte dhënë më shumë detaje mbi këte epizodë (duke thënë se ky planifikim ishte bërë në banesën e saj, se A e kishte ftuar atë t'ishite aty me të gjatë vizitës së Besnik

e numrit 044-538000 i cili I takonte Besnik Hasanit, e cila e lokalizon të akuzuarin në ora 2:39:58” të mëngjezit me anë të celulës GSM ‘Viktoria 1’ e cila e mbulon zonën e Dardanisë ku jeton M I.

¹ Dëshmia e M I, fq.8

² Vol. 14, fq 3993

³ Origjinali në gjuhën shqipe

⁴ Seansa e 25 majit 2009, fq 18

Hasani dhe dy të akuzuarve të tjerë, se ajo e kishte dëgjuar shprehjen ‘shfarosje edhe mijvë në tavan’ etj) por, ne esencë, atë çfarë dinte, ajo ishte thënë në mesazhin dërguar Faton Shoshit më 24 shtator 2007, në ora 2:39 dhe 2:42 të mëngjezit.

Atë çfarë kishte dëgjuar M I nga të akuzuarit atë natë, në banesën e saj, duhet të kuptohet me kujdes.

Deklarimet e të akuzuarve lidhur me qëllimin për të marr hak nuk i bie të jenë mënyrë e të rrëfyerit (i cili mund të ndodhë vetëm pas kryerjes së krimit). Por ato mund të konsiderohen thjeshtë shprehje e frustrimit për vrasjen e kolegut të tyre Triumf Rizës dhe e paaftësisë së policisë për të arrestuar vrasësin e supozuar (gjendje shpirtërore e cila do të mund mirë të pasqyrohej në fjalitë si “Po ta kisha këtu përpara, do ta vraja!” ose “Do ta vraja me duart e mia”). Frustrimi dhe pakënaqësia kanë mundur të shprehen një ditë apo një javë pas vdekjes së Triumf Rizës, siç edhe u konfirmua nga fjalët e po të njëjtës M I¹ (“Në kohën kur ka vdekur Triumf Riza, *ditën kur ka vdekur* në spital, e tërë SHPK-ja dhe i tërë populli shqipëtar ishin të acaruar, kushdo që e kishte zënë Enver Sekiraqën, do ta kishte vrarë atë”). Por pothuajse një muaj pas vrasjes së Triumf Rizës, kjo gjendje psikologjike e urrejtjes ishte transformuar: nga një shprehje e përgjithshme dhe tipike urrejtjeje dhe frustrimi ajo u materializua në një dëshirë specifike, në një plan të definuar aksioni kundër Sekirqaës. Detaji i dhënë në mesazh (‘bile edhe mijtë në tavan do të shafarosen’) tregon dy gjëra. Së pari, se ai i cili e kishte thënë atë fjali ishte i vetëdijshëm për potencialin e jashtëzakonshëm shkatërrues të mjetit shëprthyes. Së dyti, në kohën kur ato fjalë u dëgjuan (dy ditë para shpërthimit), fjalët nuk ishin shprehje e përgjithshme dhe palidhje e një mburrjeje të kotë; ato më tepër pasqyronin vendimin që tashmë ishte marrë (për vendosjen e bombës; të kërcënohet Sekirqa). Vendim ky kolektiv (dëshmitarja e përdorë vazhdimisht shumësin) të cilin Besnik Hasani dhe Shpend Qerimin ia komunikuan A It në prani të M It. Vullneti i grupit tashmë ishte krijuar dhe e kishte arritur tiparin e të pakthyesmes prapa gjë të cilën vendimet kolektive zakonisht e kanë (kontributi në formimin e vullnetit kolektiv, pjesëmarrësi personalisht e konsolidon dhe e përforcon gjendjen psikologjike e cila nuk mund të kthehet lehtë prapa dhe këto vendime më pak i nënshtrohen rishqyrtimit se sa vendimet individuale). E njëjta fjalë e përdorur në tekstin e mesazhit “Ndegjova” tregon se atë çfarë kishte dëgjuar M nuk ishte mundësi e mjegulltë, spekulim apo dëshirë e thjeshtë e të akuzuarve, për të cilën gjë një shprehje tjetër do t’ishite më e përshtatshme në mesazh.

Çështja e fundit në serinë e mesazheve të shkëmbyera në mes të M It dhe Faton Shoshit lidhur me natën kritike. Nuk kontestohet, mesazhi më mbresëlënës, ai i cili më së shumti kishte tërhequr vëmendjen gjatë hetimeve si dhe gjatë gjykimit është i pari: “I vëllai me shokë kanë vu dinamitin, o Zot, o Zot”. Por është mesazhi i dytë të cilin M I ia kishte dërguar Faton Shoshit i cili është më i rëndësishëm. Në fakt, vetëm nga mesazhi i dytë e marrim vesh se mesazhi i parë nuk përbën thjeshtë një hamendje të M It. Mu kur M shkruan në mesazhin e dytë se e kishte dëgjuar Besnik Hasanin dhe shokët e tij duke folur për planet e tyre, në mund ta themi se mesazhi i parë është shprehje e një dijenie faktike e jo spekulim i thjeshtë i një zonjë me imagjinatë të pasur. Nëse është kështu, atëherë verzioni i M It dhënë në Gjykatë, sipas së cilit mesazhet ishin predestinim që “të hiqen qafe katunarët”, bie poshtë. Mesazhi i parë vetvetiu nuk do i kishte ndihmuar kurrë M It që t’i heqë qafe katunarët. Kur ia kishte dërguar mesazhin e parë Shoshit, ajo nuk ka

¹ Deklaratë e dhënë tek prokurori 14.12.2007, e lexuar në gjykatë, seansa e 25 majit 2009

mundur ta dijë se Shoshi do t'i përgjigjej duke e pyetur se si e dinte për përgjegjësinë që e kishin Vëllai dhe shokët e tij. Nëse qëllimi i vërtetë i dëshmitares ka qenë t'i heqë qafe të akuzuarit, ajo do e kishte vendosur informatën në mesazhin e parë e jo në të dytin siç kishte vepruar.

Këto që u morën parasysht më lartë konfirmojnë që mesazhet që iu dërguan Faton Shoshit natën kritike kanë qenë pasqyrim i vërtetë se M ishte në dijeni dhe se çfarë kishte dëgjuar ajo nga të akuzuarit përputhej me vendosmërinë e tyre e cila u ekzekutua dy ditë më vonë. Këto tregojnë se versioni i M It dhënë në gjykatë, se vetëm kishte dashur t'i heqë qafe të akuzuarit të cilët po e trazonin atë dhe vajzat e saj është vetëm përpjekje ta ruajë veten dhe vajzat e saj nga reprezaljet për shkak të dëshmisë së saj.

Frika nga reprezaljet e cila është e justifikuar dhe e cila është konfirmuar me dëshminë e një dëshmitari në gjykatë. Në dëshminë e tij¹, dëshmitari Antonio Fulko ka përmendur se në një rast dëshmitarja e kishte vizituar zyren e tij mënyre spontane dhe se “ M I ishte shumë e frikësuar sepse na tha se përderisa po shkonte në shtëpi një mbrëmje, nga parkingu afër banesës së saj, katër individë i ishin afruar asaj dhe i kishin thënë fjalë për fjalë, ‘nëse nuk i tërhjek akuzat kundër Hasanit, do vdesësh brenda javës’; ajo gjithashtu kishte përmendur se disa prej anëtarëve të familjes Hasani e kishin thirrur vëllain e M It, tek i cili po qëndronte në atë kohë vajza e saj A ”. Kurse në gjykatë (fq. 12, seanca e 25.5.2007) M I ka konfirmuar se publikimi në gazeta i fragmenteve të deklaratës së saj i kishte shkaktuar asaj pasiguri dhe frikë.

Para gjykatës, deklarata e saj ishte kundërthënëse dhe jo e besueshme.

Kundërthënëse, sepse arsyetimet e dhëna ishin heterogjene dhe nuk përputheshin njëra me tjetrën. Në njërin anë, ajo tha që e kishte gënjyer prokurorin sepse ishte nën presion, në anën tjetër ajo tha se dëshironte t'i involvojë tre të akuzuarit.

Prej këtyre dy verzioneve, cila është ajo e vërteta?

Jo e besueshme, sepse dëshmia e saj në gjykatë është përtej mase konfuze dhe e mjegullt. Përgjigjet cilat ajo i ka dhënë nuk ishin të plota, të folurit e saj shpesh ndërpritej, përgjigjet saj jo gjithmonë ishin përgjigje në pyetje. Kjo gjendje e deklaratës së saj nuk ishte për shkak të rrethanës, e cila ishte theksuar gjatë deklaratës së vajzës së saj E², se M është psikikisht jo-stabile dhe se ajo “merr tableta”, por për shkak të faktit se M ishte përpjekur pa sukses ta montojë një verzion të ri të fakteve. Në fakt, kur ajo kishte dhënë deklaratën e saj para prokurorit më 14 dhjetor 2007, deklarata e saj ishte e përputhshme, koherente dhe e qartë.

Si përfundim, konstatohet se M I i ka gënjyer trupit gjykues kur thotë se deklaratat e saj të mëhershme para prokurorit ishin të rrejshme dhe montim.

1 Seanca e 28 majit 2009, fq. 22

2 Seanca e 2 qershorit 2009, fq.49

Përkundrazi trupi gjykues është i mendimit se deklarata e dëshmitares dhënë gjatë hetimeve (me 14.12.2007) është e vërtetë dhe e besueshme. Jo vetëm për arsye të detajeve të cilat, siç u tha më herët të njëjtit hetues nuk i dinin në atë kohë, por gjithashtu për arsye se rrëfimin që e jep dëshmitarja në atë deklaratë është tregim i logjikshëm, koherent i rrethanave të mundshme.

Në deklaratën e saj, M I cek qartë fakte dhe emra, asaj i kujtohen epizoda dhe rrethana me saktësi, ajo vendos gjëra në kontekst duke dhënë arsye dhe justifikime për fjalët e saj. Pak muaj pas ngjarjeve (vrasjes së të fejuarit të vajzës së saj dhe shpërthimit), ajo ishte plotë përbuzje dhe tronditje për atë çfarë kishte ndodhur, ndjenjat që i kishte përkritazi me kryerjen e krimeve të tilla të neveritshme ende mbizotëronin mbi tjera mendime edhe e shtyenin atë të flasë dhe ta thotë të vërtetën¹. Dduke qenë spontane gjatë kohës kur e kishte dhënë deklaratën e saj para prokurorit, M I e ka ndjerë sinqerisht nevojën të flasë dhe t'ua tregojë hetuesve rrethanat për të cilat ajo mendonte se ishin të rëndësishme për hetime. Një vit e gjysmë më vonë, në gjykim, shtigje tjera janë paraqitur duke pasur tendencë të mbizotërojnë. Frika e ndonjë reagimi të mundshëm, nevoja për ti mbrojtur vajzat e veta, dëshira për t'i lënë këto përvoja të këqija prapa dhe të vazhdojë më tutje me jetën e vet e kanë shtyrë atë të vijë në gjykatë dhe ta ndryshojë verzionin e saj. Kjo mënyrë e re të menduarit shihet mirë në vendimin e saj për të heqë dorë nga anonimiteti dhe nga mundësia për të dhënë dëshmi ndarazi. Gjë e cila e gjen justifikimin e vet në gjendjen e re shpirtërore².

Deklarata e dytë e M It e dhënë para prokurorit duhet kështu të mirret si deklaratë autentike e dëshmitarës. Siç u tha, në bazë të nenit 364 të KPPPK-së, ajo deklaratë u lexua në procesverbalin e gjykimit në seancën e 25 majit 2007 dhe tani trupi gjykues mund ta konsiderojë atë si rrëfim të besueshëm të fakteve.

E I e ka përshkruar nënën e saj jo-stabile dhe të dobët psikikisht, duke shtuar se nuk duhet tu besohet fjalëve të saj dhe se ajo merr tableta (seanca e 2 qershorit, fq. 29). Ky koment nuk është i besueshëm dhe duhet të kuptohet, sipas mendimit të trupit gjykues, thjeshtë si përpjekje për ta mbrojtur nënën dhe vetveten nga pasojat e deklaratave të cilat M I i kishte dhënë para prokurorit. E I nuk e kishte përmendur më herët gjendjen e pretenduar të nënës së saj, përveç kësaj, deklarata e saj ishte në tërësi e ndikuar nga përpjekja e paturpshme që ti fshehtë gjithashtu rrethanat më evidente; e konfrontuar me pyetjet e sakta dhe specifike të prokurorit, ajo vazhdimisht është përpjekur t'i shmangte pyetjeve, duke i provokuar vërejtjet e njëpasnjëshme të kryetarit të trupit gjykues i cili e ftonte atë që tu përgjigjet pyetjeve duke i përkujtuar asaj se ajo ishte vetëm dëshmitare e cila nuk duhej të sillej "si diva" në gjykatë. Me këtë shprehje të fundit, kryetari i trupit gjykues i referohej sjelljes së dukshme teatrale të Emës e cila kishte ardhë në gjykatë si një aktore për të dhënë intervistë. Trupi gjykues e ka vlerësuar shumë të ulët besueshmërinë e saj për arsye të mohimeve të një pas njëshme të cilat ajo i bënte, përgjigjeve një- rrokëshe, qasjes provokative të dëshmitares në përgjithësi, të cilat shihen qartë në procesverbal.

¹ Deklarata e 14.12.2007 para prokurorit: "isha e irluar me atë se cka po dëgjoja kur ata thonin se do të marrin hak dhe gjithësesi do ta bëjnë atë gjë. Nuk më pëlqejn këto gjëra dhe besoj shumë se është ligji ai që duhet të përkujdeset për këto gjëra".

² Seanca e 25.05.2007, fq.7: *nuk kam nevojë për mbrojtje. Po për shkak të gazetave kam vendosur të jap dëshmi haptazi.*

Ta bazosh konkludimin përfundimtar mbi aftësinë e M It dhe besushmërinë e fjalëve të saja duke u bazuar në vlerësimin të cilitin e jep E I përkitazi me atë se sa duhet ti besohet nënës së saj, do të ishte gabim. Në asnjë pjesë e deklaratës së saj para gjykatësve në Dubravë, M I nuk e ka lënë përshtypjen të jetë jo-stabile mentalisht apo e paafte për t'i mbajtur mend gjërat apo për ti vendosur epizodat e së kaluarës në perspektiven e duhur. Përkundrazi, siç e ka vërejtur edhe kryetari i trupit gjykues kur e kishte ftuar ta arsyetojë vendimin e saj për të dhënë dëshmi në publik, ajo u duk të jetë grua mjaftë inteligjente, mirë e vetëdijshme për rrethin ku jeton dhe për pasojen e fjalëve të saja. Thjeshtë, person me performance normale intelektuale e cila nuk ka treguar mangësi psikike apo te meta mendore. Ideja se është e mundur që ajo t'i ketë shpikur rrethanat apo t'i ketë keqinterpretuar ato është kështu jo-egzistente dhe denigrimi të cilit i nënshtrohet ajo nga vet vajza e saj është konfirmim i papërgjegjësive së pakuptimta të E It.

3. Informacione në lidhje me vdekjen e Neshat Baftiut dhe dy të tjerëve.

Një pjesë tjetër themelore e provave rrethore në vlerësimin e akuzave kundër Besnik Hasanit, Shpend Qerimit dhe Nusret Cenës për pjesëmarrjen e tyre të pretenduar në vendosjen e bombës në Bulevardin Bill Clinton natën e 24 Shtatorit 2007 vjen nga dëshmitarët A B, A T, R M, M A dhe nga dëshmitarët anonim Omega dhe Theta.

Dëshmitarët e përmendur janë paraqitur në gjykatë për tu dëgjuar në rrethanat në lidhje me vrasjen e Neshat Baftiut, i vrarë natën e 27 Shtatorit 2007 së bashku me dy kushërinj të tij të afërt përderisa kthehej në shtëpi pasi që kishte dalë atë mbrëmje. Gjatë ngjarjes janë lënduar rëndë edhe dy anëtarë tjerë të ri të familjes së Neshat Baftiut.

Cila ishte rëndësia e vrasjeve dhe provave në lidhje me to në këtë çështje, dikush mund të pyet.

Neshat Baftiu ka qenë një djalë i ri i cili, pretendon prokurorja, i ka njohur anëtarët (së paku disa prej tyre) të grupit i cili e ka vendosur bombën në restorantin Sekiraqa dhe ka qenë i informuar për planifikimin e vendosjes së bombës sepse atij i ishte ofruar që të jetë pjesëmarrës në komplot. Prokurorja pretendon që ai ka qenë objektivi (objektivi i vetëm) i sulmit i cili ka ndodhur tre ditë pas shpërthimit; motivi i sulmit ka qenë që Neshat Baftiu, në disa ditët në mes të shpërthimit dhe vdekjes së tij, ka folur në mënyrë të pamatur për atë që e ka ditur në lidhje me vendosjen e bombës.

Para ekzaminimit të deklaratave të dëshmitarëve, duhet theksuar që prej gjashtë personave të përmendur në lart (A B, A T, R M, M A, Omega dhe Theta), vetëm i pari, A B, vëllai i Neshat Baftiut dhe kushëriri i afërm i viktimave tjera të sulmit të 27 Shtatorit 2007, ka qenë i përfshirë në listën e dëshmitarëve në aktakuzë. Dëshmitari është dëgjuar gjatë seancës së katërt të shqyrtimit gjyqësor, të mbajtur më 19 Maj në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë.

Të tjerët janë ftuar në gjykatë që të dëshmojnë në një fazë shumë të mëvonshme, kur të gjithë dëshmitarët e përmendur në aktakuzë tashmë ishin dëgjuar. Dëshmia e A T është kërkuar nga prokurorja më 9 Qershor dhe është pranuar nga trupi gjykues me vendimin e lëshuar gojarisht në fillim të seancës së ardhme (16 Qershor 2007); katër dëshmitarët tjerë

(R M, M A, Omega dhe Theta) janë ftuar me vendim autonom të trupit gjykues, të arritur gjatë seancës së 19 Gushtit 2009.

Dy vendimet e trupit gjykues kanë nxitur një reagim të fortë të avokatëve mbrojtës të akuzuarve, duhet përkujtuar.

Veçanërisht me rastin e dytë, kur trupi gjykues ka marrë iniciativën që të dëgjojë dëshmitarët që A T i ka përmendur gjatë marrjes së tij në pyetje, avokatët mbrojtës e kanë kundërshtuar aktvendimin e trupit gjykues me një virulencë e cila reflektohet vetëm pjesërisht në procesverbalin e seancës.

Komentet e avokatëve (dy faqe të plota të procesverbalit) e kanë kualifikuar vendimin e trupit gjykues si “të paligjshëm, të padrejtë, jashtë kufijve të shqyrtimit gjyqësor”. Një avokat e ka shprehur brengën e tij në lidhje me mënyrën si po mbahej shqyrtimi gjyqësor dhe “me këtë mënyrën si ju si Kryetari i Trupit Gjykues po komunikoni me Prokuroren Publike (1) në fund duke e konsideruar veprimin e ndërmarrë...si paragjykim nga trupi gjykues ndaj mbrojtjes”; një avokat tjetër ka pranuar që është “tmerruar thellësisht nga ky propozim”.

Përsëri, kur në fund dëshmitarët u paraqitën, në seancën e ardhme (25 Gusht 2009), një avokat mbrojtës me ngazëllim ka kundërshtuar marrjen në pyetje të parit prej tyre, në një mënyrë e cila lehtë mund të përshkruhet si penguese, me pengime të përsëritura, duke kallëzuar që po bëhej një shkelje e patolerueshme dhe duke shpallur që “në përgjigje ndaj veprimeve të tilla të juaja, edhe pse kundër dashjes sime, unë do të detyrohem që ti drejtohem zyrës së EULEX-it dhe të kërkoj nga asambleja e gjykatësve që të shqyrtojë veprimet që ju i keni ndërmarrë në këtë shqyrtim gjyqësor”.

Reagimi ndaj vendimit të trupit gjykues mund të përshkruhet si një reagim i tepruar apo një përgjigje hysterike ndaj një vendimi gjyqësor. Vendimi mund të jetë i gabuar (ka mënyra dhe mjete për të përmirësuar gabimet që i bëjnë gjykatësit) por nuk është argument ligjor që të fajësohet Kryetari i Trupit Gjykues për komunikim jo rutinor me Prokuroren Publike (një akuzë që ishte e pavërtetuar dhe, natyrisht, e pabazë). Reagimi jashtë mase i avokatëve e ka dhënë përshtypjen që ata nuk ishin kundër mënyrës në të cilën parashtroheshin provat në shqyrtim gjyqësor, por kundër përmbajtjes së provave.

Përveç fjalëve të ndryshme të përdorura nga avokatët mbrojtës, thelbi i kundërshtimeve të të gjithë atyre ishte i njëjtë: ata kanë pretenduar që duke thirrur për të dëshmuar përpara këtij trupi gjykues dëshmitarë që janë relevant për një hetim tjetër, trupi gjykues po “zgjëronte” apo “plotësonte” apo “ndryshonte” (këto ishin shprehjet që janë përdorur) aktakuzën kundër Besnik Hasanit, Shpend Qerimit dhe Nusret Qenës. Është thënë³ që kjo përbën “një shkelje të Neneve 5 apo 6.2 të KEDNJ që vendos një shqyrtim gjyqësor sipas standardeve” dhe që trupi gjykues është dashtë të vijojë procedurën e paraparë në nenin 376 KPPK. Avokati Azem Villasi ka bërë vërejtje që neni 222 KPPK cekë që hetimet mund të zhvillohen vetëm sa i përket një çështje penale e cila është vërtetuar me një aktvendim për fillimin e hetimeve. Përfundimisht, avokatët kanë shprehur befasinë e tyre për marrjen e një vendimi të tillë kur po afrohej përfundimi i shqyrtimit gjyqësor.

³ Znj. Vahide Braha 19 Gusht 2009, f. 9

Përgjigja ndaj kundërshtimeve nuk do të jetë e gjatë, pasi që pikat kryesore tashmë janë sqaruar gjatë dëgjimit.

Sipas mendimit të trupit gjykues (vendimi i marrë me 19 Gusht, si ai i 16 Qershorit, nuk është marrë vetëm nga ana e Kryetarit të Trupit Gjykues⁴) dispozitat e neneve 7, 152,2, 333.2 dhe 360.5 KPPK janë të mjaftueshme për të arsyetuar aktgjykimin: në këto nene shprehet qartë detyra e trupit gjykues që jo vetëm të vlerësojë plotësisht faktet për të cilat i tërhiqet vëmendja, por gjithashtu “të vërtetojë në mënyrë të vërtetë dhe të plotë faktet që janë të rëndësishme për lëshimin e një vendimi të ligjshëm”. Për të kryer këtë detyrë, trupi gjykues nuk mund të limitojë vetëm dhe të ketë vetëm një rol pasiv nëse ka mbetur një zonë ngjyrë hiri në prova, e cila ende mund të sqarohet. Trupi gjykues mund të merr iniciativë autonome nëse e sheh të përshtatshme: neni 360.5 KPPK urdhëron saktësisht që “përveç provave të propozuara nga palët...trupi gjykues do të ketë autoritet që të mbledh provat që i konsideron të nevojshme për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të çështjes”. Një iniciativë që mund të merret deri në fazën e fundit të shqyrtimit gjyqësor, siç specifikohet në nenin 383 KPPK, “nëse pas fjalëve përfundimtare të palëve, trupi gjykues...gjen se ekziston nevoja për...prova të mëtejme”.

A ka shkelur vendimi për pranimin e dëshmitarëve ndonjë të drejtë të akuzuarve? A është dashtë të ndryshohet aktakuza?

Përgjigja në pyetjet është natyrisht jo.

Nenet 5 dhe 6.2 i KEDNJ nuk kanë rëndësi këtu: dispozita e parë dikton standardet minimale për një arrestim të ligjshëm dhe nuk merret me shqyrtimin gjyqësor; dispozita e dytë e përmendur nga avokatja Vahide Braha ka të bëjë me supozimin e pafajësisë, që qartësisht nuk është relevant në këtë temë.

Mbi ndryshimin e aktakuzës, trupi gjykues vëren që me vendimin për dëgjimin e dëshmitarëve A T, R M, M A, Omega dhe Theta, nuk është bërë asnjë ndryshim i akuzave kundër të akuzuarve, të cilët ende janë të akuzuar për krimet e cekura dhe të përshkruara në tri pikat e mbetura të aktakuzës origjinale.

Fakti që trupi gjykues është i mendimit që është e përshtatshme që të sqarojë disa rrethana që gjithashtu janë duke u hetuar në një procedurë tjetër nuk ka ndryshuar e as zgjëruar përmbajtjen e aktakuzës: një fakt (për shembull vrasja e tre burrave të ri dhe prania e mundshme e të akuzuarve në vendngjarje në momentin kur ka ndodhur vrasja) mund të jetë subjekt i një hetimi dhe mund në të njëjtën kohë të jetë një rrethanë me vlerë provuese në një tjetër, ku akuzat janë ndryshe. Kjo ndodhi nuk është e pazakontë në asnjë sistem juridik, kur për shembull një falsifikim i dokumenteve është i dobishëm për shmangien e tatimeve dhe për ndonjë arsye dy krimet gjykohen ndaras.

Pas këtij sqarimi, mund të përqendrohemi në përmbajtjen e deklaratave të dëshmitarëve.

A B ka dëshmuar më 19 Maj 2009. Ai është futur në listën e dëshmitarëve në këtë shqyrtim gjyqësor për diturinë e tij të supozuar mbi arsyet e vrasjes së kushëririt të tij Neshat Baftiut.

⁴ Seanca 19.8.09, f. 8: “trupi gjykues ka vendosur që të merr...iniciativë...”.

Përkundër përmbajtjes dhe ngurrimit të dëshmitarit për të folur¹, gjatë dëshmisë është shfaqur që arsyeja për vrasjet e shumëfishta qëndron në sjelljet e Neshat Baftiut pas vendosjes së bombës dhe në mënyrën në të cilën ai ka folur me një numër personash për dijeninë e tij të rrethanave në lidhje me vendosjen e bombës.

Relevant për çështjen, është paragrafi në vijim: (f.15/16):

Prokurorja Publike: Pyetja ishte, kur vëllai yt ka thënë që këtë e ka bërë njësia speciale, a të ka thënë kështu ty?

A B: Ai nuk ma ka thënë këtë mua; ai na ka thënë këtë të gjithë neve, një grupi të njerëzve.

Prokurorja Publike: Ai, kur e ka përmendur shpërthimin Sekiraqa, a e ka përmendur fare Besnik Hasanin?

A B: Po, dhe kur e kam pyetur si e ka ditur atë ai ka thënë që vetëm ka supozuar ashtu.

Prokurorja Publike: A mund të përkujtoj për atë që ia ke thënë policisë. Në deklaratën tënde të parë të dhënë më 31 Mars 2008, ti ke thënë që kur ti ke pyetur se si e dinte ai atë, ai është përgjigjur, “Le tash, shpresoj të mos kesh punë me ta, ata janë në gjendje të bëjnë gjithçka.”

A B: Unë nuk e kam thënë këtë.

Prokurorja Publike: Në deklaratën tënde të dytë, të datës 27 Mars 2008, policia në fund të deklaratës të ka pyetur: “A dëshiron të shtosh diçka?”, dhe ti vullnetarisht je përgjigjur: “Neshati më ka thënë që grupi i Besnik Hasanit dëshiron që unë të ju bashkohem atyre, por Neshati ka refuzuar, sepse nuk është i gatshëm të bëjë atë që ata po e bëjnë. Sipas mendimit tim, ky grup e ka eliminuar atë sepse ai i ka ditur gati të gjitha për këtë grup duke përfshirë rastin e bombës. Kur ka ndodhur sulmi me bombë ai më ka thënë që ata janë të dyshuarit kryesor në këtë rast dhe që ai ka qenë në gjendje të hakmerret për vrasjen e Triumf Rizës pa shpërblim, unë e di që Neshati ka pasur lidhje të ngushta me Besnik Hasanin”. Kjo ka qenë shtesë vullnetare në deklaratën tënde: a pajtohesh që ti e ke thënë?

A B: Disa janë të vërteta dhe disa jo.

Prokurorja Publike: Cilat?

A B: Nuk e di saktësisht ku ka qenë ai dhe ku ka shkuar dhe me kë dhe çfarë ka bërë.

Vrasja e Triumf Rizës ka qenë tronditëse për ne dhe unë e di që Neshati ka qenë në gjendje të bëjë gjithçka. A ke thënë sepse ai ka qenë aq i shqetësuar apo sepse ka dashtë që ta bëjë shokun e tij Besnikun më të famshëm apo më të vlefshëm.

Prokurorja Publik: Unë nuk kam pyetur çfarë ka dashtë të thotë; unë kam pyetur se a ka thënë ai kështu?

A B: Po, unë i kam thënë ato sepse ne jemi frikësuar që diçka mund të del nga ana jonë dhe unë kam të drejtë të dyshoj çdo person.

Prokurorja Publik: Mendoj që pyetja e fundit që ta kam bërë ka qenë se a ka dëgjuar ti në mënyrë indirekte që Shpend Qerimi dhe Nusret Cena janë përmendur në kryerjen e vendosjes së bombës. A i ka përmendur Neshat Baftiu ata drejtpërsëdrejti?

A B: E ka përmendur në mënyrë indirekte, por nuk mendoj që e ka thënë me njëqind përqind bindje dhe tani ai është i vdekur.

¹ Shih më lart, shënimi 1 në faqen 9

Rëndësia e deklaratës së A Bt qëndron në lidhjen që mund të vërtetohet në mes të dijenisë që e kishte Neshat Baftiu për organizimin e vendosjes së bombës dhe vdekjes së tij (dhe të kushërinjve të tij). Kjo lidhje arsyetohet në masë të mjaftueshme me afërsinë në mes të dy ngjarjeve (vendosjes së bombës dhe vrasjeve) dhe sjelljeve të Neshat Baftiut në atë periudhë kohore.

Çiltërsia e pamatur me të cilën ai fliste për vendosjen e bombës që sapo kishte ndodhur (A B: Ai (Neshati) nuk ma ka thënë këtë mua; ai na ka thënë këtë të gjithëve, një grupi njerëzish) dhe për përfshirjen e Besnik Hasanit në të (deklarata e datës 27 Mars 2008: “Neshati më ka thënë që grupi i Besnik Hasanit dëshiron që unë – do të thotë Neshati – ti bashkohem atyre, por ai ka refuzuar, sepse ai nuk është i gatshëm të bëj atë që ata janë duke e bërë...E di që Neshati ka pasur lidhje të ngushta me Besnik Hasanin.”) logjikisht lidhet me vrasjen pasuese, duke marrë parasysh brutalitetin e sulmit kundër anëtarëve të familjes Baftiu, për të cilën nuk është raportuar ndonjë histori dhune apo kundërshtimesh që në të kundërtën do të arsyetonte sulmin¹.

Në këtë sfond, tani ekzaminohet dëshmia e dëshmitarëve tjerë mbi vrasjet e 28 Shtatorit 2007 afër urës së Lepencit.

A T, polic përgjegjës për hetimet e vrasjes së trefishtë, ka paraqitur një rikonstruksion të përgjithshëm të ngjarjeve dhe të hetimeve pasuese, siç shfaqeshin nga deklaratat e dëshmitarëve të mbledhura deri tani. Ai u kujtua që disa deklarata tregonin për praninë e Shpend Qerimit dhe të një individi tjetër në vendngjarje disa minuta para se të ndodhnin vrasjet. Ai ka përmendur rrethanën që një patrullë e policisë, e drejtuar për në vendngjarje për ndihmë të parë, ka ndalur dhe kontrolluar një Volkswagen Golf të bardhë në të cilin ishin Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi, që ka ardhur nga drejtimi i vendngjarjes dhe që ka hy në rrugën kryesore disa minuta pasi që kishte ndodhur krimi. Më tej, ai e ka përmbledhur dëshminë e dhënë nga një kushëri tjetër i Neshat Baftiut, Bujari, i cili e ka mbijetuar sulmin, i cili ka thënë që vrasja e Neshat Baftiut është organizuar nga Besnik Hasani, Shpend Qerimi, Nusret Cena dhe të tjerë (Fikri Hasani, Xhabir Zharku dhe Afet Dalloshi).

Dëshmia e A T është informatë e dorës së dytë në bazë të leximit dhe ekzaminimit të dosjeve të një lënde tjetër nga ana e tij. Megjithatë, është relevante (sepse na lejon të kemi një pasqyrë të çështjes dhe një kuptim të përgjithshëm të mënyrës në të cilën janë kryer hetimet) dhe e pranueshme. Më tej, nuk është produkt intelektual i një lexuesi të thjeshtë por është e bazuar në eksperiencën e tij si polic, i ngarkuar specifikisht me detyrën e këqyrjes së dosjes së lëndës për finalizimin e saj dhe prezantimin e mundshëm në gjykatë.

Të vendosura në pasqyren e përshkruar nga dëshmitari Tetaud, tregimet për ngjarjet e natës në mes të 27 dhe 28 Shtatorit 2007 nga ana e dëshmitarit të dëgjuar më 25 Gusht 2009 ishin menjëherë të qarta.

R M dhe M A janë policë, anëtarë të një njësie patrulluese e cila ishte në detyrë në zonën e fshatit Dubravë dhe e cila ishte thirrur nga shtabi dhe drejtuar për në vendngjarje.

Tregimi i tyre përqendrohej në ndalimin nga ana e tyre të veturës që hynte në rrugën kryesore nga një rrugë anësore. Rruga anësore çon, pas disa kilometrave, te vendngjarja

¹ Dëshmitari Tetaud përmend që Neshat Baftiu ka pasur dosje penale të nivelit të mesëm dhe ka pasur një kontest për tokë. (seanca 1 Qershor 2009, f. 17)

(Muca: “Rruga e njëjtë të çon në vendngjarje, edhe pse janë disa kilometra në pyetje” f. 6; Ajeti: Vinte nga drejtimi ku kishte ndodhur ngjarja” f. 17) Të dy dëshmitarët, së pari me ngurrim fillestar, kanë pranuar që vendimi i tyre për të ndaluar veturën kishte rrjedhur nga dyshimi që vetura dhe pasagjerët e saj kanë pasur lidhje me vrasjet që sapo kishin ndodhur (M A: Si e pamë veturën, dhe pasi që vetura ishte duke ardhur nga drejtimi i vendngjarjes, ne e kemi ndaluar veturën). Ekzaminimi i hartës¹ së paraqitur nga avokati Mahmut Halimi e mbështetë përfundimin: distanca në mes të urës së Lepencit (vendngjarja) dhe “sheshit të flamurit” afër fshatit Sllatina është disa kilometra, më pak se 6-7 siç hamendësonte dëshmitari i parë R M (f.9), që përputhet me kohën që dëshmitari i njëjtë e vlerësoi si të nevojshme për të arritur në vendngjarje (10 minuta, përfshirë ndalimin e veturës së Hasanit – rendi i parë i f. 10) dhe absolutisht nuk përputhet me indikacionin e dhënë nga Besnik Hasani gjatë marrjes së dëshmitarit në pyetje (më shumë se 22 km! – f. 10, rreth fundit).

Besnik Hasani diskutoi me dëshmitarin e parë që ai ka qenë duke e ngarë një veturë zyrtare, një Volkswagen Golf “me targa KS” (Hasani, seanca 25 Gusht 2009, f. 12). Mbi këtë pikë, i akuzuari ka deklaruar “Tërë këtë gjë e ka sajuar policia. Ata vazhdonin të thonë që unë kam qenë në një veturë tjetër, por vetura ime ka pasur targa KS”.

Trupi gjykues mendon që detaji mbi tipin e veturës nuk është relevant. Sidoqoftë, diskutimi nuk është i besueshëm. Të dy dëshmitarët (R M dhe M A mbajnë në mend një Golf të bardhë (nëse gjithashtu ka pasiguri edhe rreth tipit, 2 apo 3), një veturë civile, e cila është qartësisht ndryshe nga një veturë zyrtare. Më tej, dëshmitarët kanë thënë që arsyeja për ta ndaluar veturën, pasi që e kanë tejkaluar, ka qenë dyshimi që kjo ka lidhje me vrasjen e trefishtë që sapo kishte ndodhur, dyshim që nuk do të ishte ngritur në rast të një veture zyrtare¹. Siç u tha, Besnik Hasani e ka interpretuar ndërrimin e dukshëm të tipit të veturës si një indikator që Policia (policia civile e UNMIK-ut apo Forcat e Policisë së Kosovës?) e kanë “sajuar tërë këtë gjë”. Për këtë pohim, i cili përsëritë pretendimin që tërë hetimet janë një trillim i orkestruar nga dikush në dëm të tij dhe të kolegëve të tij, nuk është dhënë asnjë shpjegim i arsyeshëm. E as nuk është lehtë që trupi gjykues të kuptoj arsyen e mundshme për përndjekjen e dy policëve nga ana e kolegëve kombëtarë ose ndërkombëtarë.

Dëshmitari Omega dhe dëshmitari Theta kanë përshkruar atë që e kanë parë në afërsi të vendngjarjes së vrasjeve të shumëfishta pak minuta para se të ndodhte sulmi. Ata kanë qenë duke ecur në rrugë, duke u kthyer në shtëpi pasi që kishin dalë në Kaçanik; ata e kanë parë një veturë (të përshkruar si një Audi A4 ose A6) e cila i kishte tejkaluar, ata e kanë vërejtur dikë duke dalë nga vetura; ata kanë kaluar pranë; ata kanë nxituar nga ai vend dhe, disa minuta më vonë, kur kanë arritur në shtëpi, kanë dëgjuar të shtëna. Ka pasur disa mospërputhje në mes të dy dëshmitarëve. Njëri ka qenë më i hollësishëm (Omega, i marrur në pyetje për dy orë e gjysmë): atij i kujtohej prania e dy individëve, dhe ka dhënë një përshkrim të mirë të modelit të flokëve të njërit prej tyre; ai ka vërejtur që ky person kishte një armë automatike në dorë; ai kujtoi ndjenjën e frikës të provokuar nga pamja e dy burrave në mes të natës në mes të kurrkundit. Tjetri (i marrë në pyetje

¹ Bashkangjitur procesverbalit të seancës 25 Gusht 2009.

¹ Riza Muca: Në momentin që e kam ndaluar veturën, kam parë që brenda ishte i ulur një kolegë i yni. Ishte Besnik Hasani...Prokurorja Publik: Pse e ke ndërruar mendjen sa i përket bastisjes së veturës? Riza Muca: Sepse Besnik Hasani ka qenë polic i cili e lufton krimin; kam menduar që nuk ka arsye për ta kontrolluar veturën e tij.

për më pak se gjysmë ore) mbante në mend vetëm një person, ai nuk ia ka parë fytyrën; ai nuk ka përmendur armë.

Mbi disa rrethana relevante, megjithatë, tregimet e tyre përputhen ose janë shumë të afërta; shikueshmëria, përkundër orëve të natës “ende ishte në rregull” (Theta), “ishte natë, ishte errët...por ishte qiell i pastër, shihej mirë” (Omega, f. 11); tipi dhe modeli i veturës që i ka tejkaluar; distanca minimale në mes të dëshmitarëve dhe personave që ata i kanë vërejtur (5/6 metra për Omegën, 15 për Thetën), veshja e errët e personit i cili ka hy në fushë nga ana e rrugës, distanca kohore në mes të takimit befas dhe të shtënave.

Pika e parë e vlerësimit të deklaratave të dëshmitarëve është vërejtja e evidente që ata nuk janë marrë vesh mbi versionet që do të ja prezantojnë hetuesve ose gjykatësve; detaji, absolutisht qendror, i numrit të individëve që kanë dalë nga Audi, përndryshe do të kishte dal në shesh dhe do të ishte krijuar një version i përbashkët. Kjo do të thotë që teoria e trillimit të akuzës (e paraqitur nga të akuzuarit e njëjtë, siç shihet në faqen 24) në dëm të Besnik Hasanit, Shpend Qerimit dhe Nusret Cenës është e pabazë dhe e përdorur si një pretendim mashtrues nga të tretë. Përkundrazi, kjo mospërputhje makroskopike në mes të dy versioneve dëshmon për integritetin e tyre. Rrethana gjithashtu tregon që dy dëshmitarët as nuk kanë biseduar në mes tyre për ngjarjen pasi që ka ndodhur; përndryshe, do të kishin sqaruar ose do të kishin ditur për dy versionet ndryshe. Dhe kjo do të ishte shfaqur gjatë marrjes së tyre në pyetje, ose në gjykatë ose gjatë hetimeve. Rrethana që asnjëri prej tyre nuk e ka përmendur versionin e dëshmitarit tjetër, e as nuk dukej se e din atë, konfirmon vërtetësinë e deklaratës së dëshmitarit Omega mbi çështjen (f.17: Unë kurrë nuk kam pasur rast të bisedoj me të. Unë i kam punët e mia dhe ai të tija, pra unë nuk kam pasur rast që të bisedoj me të...Mua nuk më intereson kjo. Unë nuk kam këso lloj problemesh. Unë i kam problemet e mia) duke i dhënë kredibilitet të mëtejshëm fjalëve të dëshmitarit (standardi i kredibilitetit subjektiv).

Procesverbali i dëgjimit tregon që avokatët mbrojtës në mënyrë të përsëritur i kanë pyetur dëshmitarët për rrethanat që i bënë ata që të dëshmojnë para hetuesve, duke supozuar që versionet e tyre mund të jenë stimuluar nga ndokush në ndonjë mënyrë të interesuar për të gjetur dy dëshmitarë. Kjo është veçanërisht e evidente në marrjen në pyetje të dëshmitarit Omega nga ana e avokatëve mbrojtës të Besnik Hasanit dhe Shpend Qerimit kur ata kanë dashtë të dijnë kur e ka dhënë dëshmitari deklaratën, pse, me kërkesë të kujt, në çfarë roli, dhe kështu më tej. Mosbesimi i avokatëve mbrojtës ndaj një dëshmitari që dëshmonte mbi rrethanat që ai i di, thjeshtë për shkak të ndjenjës së tij të detyrës ndaj shoqërisë, është i rëndësishëm. Ai nuk e pakëson vlerën e kredibilitetit të dëshmitarit në fjalë, i cili ka ardhur në gjykatë përkundër kërcënimeve që i ka marrë.¹

Tregimi i dëshmitarit Omega është logjik, i thjeshtë dhe i besueshëm, sepse ai pjesërisht konfirmohet me deklaratat e dëshmitarit Theta dhe sepse është i sigurt dhe nuk është i paragjykuar nga interesi personal. Divergjenca mbi numrin e individëve që kanë dalë nga Audi nuk duhet të theksohet dhe mund të arsyetohet thjeshtë me ndodhinë e pazakontë që dy dëshmitarët e kanë përjetuar në atë moment.

¹ Crf. memo i, ku referohet që disa ditë para dëgjimit të tij në Dubravë, dëshmitarin e kanë vizituar kushërinjtë e Cenës.

Mënyra e identifikimit të Shpend Qerimit, gjithashtu, nuk lë mëdyshje dhe nuk e shtynë trupin gjykues që ti jep besim mundësisë që identifikimi ka qenë i ndikuar.

Është e vërtetë që Omega nuk e ka njohur Shpend Qerimin para ngjarjes dhe që ai kurrë nuk e kishte parë më herët; megjithatë, përkundër kujdesit që dëshmitari shumë herë e ka shfaqur në tregimin e tij, dhe konfuzionit të mundshëm në sekuencën e fakteve kur ai e ka mësuar emrin e Shpend Qerimit, nga fjalët e tij shihen qartë bindja dhe sinqeriteti i tij në lidhje me identifikimin e tillë.

Kujdesi që ai e shfaq (“mund të ketë qenë ky person ose dikush tjetër, por unë besoj që ka qenë ky person”; “personi që e kam parë, i ngjante Shpendit...mund të mos ketë qenë Shpendi. Unë nuk mund të them që ai person ishte Shpendi”) gjatë dëgjimit nuk ka qenë i pranishëm në deklaratën që ia ka dhënë Prokurores ku ai ka shprehur një nivel të lartë të sigurisë (“Unë jam 500% i sigurt”, f.); këto në mënyrë domethënëse reflektojnë atmosferën në të cilën është mbajtur seanca dhe tensionet të cilave i janë nënshtruar dëshmitarët përkundër dhënies së dëshmisë prapa një xhami mbrojtës. Fjalët e cekura më parë gjithashtu duhet të lexohen në frymë të shprehjeve të ngjashme të përdorura nga i njëjti dëshmitarë sa i përket pronësisë së Audit që ai e ka parë atë natë ()

Dëshmitari pjesërisht ka shfaqur konfuzion në kujtimin e ngjarjes gjatë së cilës ai e ka mësuar emrin dhe identitetin e të akuzuarit Shpend Qerimi. Fillimisht ai ka deklaruar që në një kafene në Ferizaj, përderisa pinte kafe me A Bn, ai e ka parë Shpend Qerimin duke hy në kafene dhe menjëherë e ka njohur atë si personin të cilin e kishte parë në vendngjarje. Më vonë, gjatë marrjes në pyetje, ai ka thënë që Baftiu i ka thënë atij që personi që ka hy në kafene quhet Shpend Qerimi dhe që ai është personi i përfshirë në vrasjen e kushërinjve të tij.

Nuk është e kontestueshme që Omega nuk e ka njohur identitetin e Shpend Qerimit para se që atë ia ka treguar A B (përndryshe ai thjeshtë do të kishte dëshmuar që ai e ka parë Qerimin në vendngjarje). Gjithashtu nuk është e kontestueshme që Omega e ka mësuar identitetin e Qerimit rastësisht, për shkak të hyrjes së Qerimit në kafenenë ku Omega ishte duke pirë kafe me Baftiun.

Pretendohet që identifikimi është ndikuar nga indikacioni i dhënë nga Baftiu mbi identitetin e njeriut që ka hy në kafene dhe pjesëmarrjen e tij në vrasjen e kushërinjve të tij.

Trupi gjykues vëren që pretendimi është i pabazë.

Pasi që Baftiu ka qenë i interesuar në zbulimin e identitetit të vrasësve të kushërinjve të tij, me qëllimin që ata të vihen para drejtësisë (siç ka treguar ai gjatë dëshmisë së tij), atëherë pse ti lihet rastit identifikimi i Shpend Qerimit, në të cilin ai ka dyshuar? Duke ditur që Omega ka qenë i pranishëm në vendngjarje, nuk ka arsye për të besuar që Baftiu do të priste një muaj po të kishte pasur qëllimin që ti “sugjerojë” dëshmitarit Omega emrin e Qerimit. Mënyra si janë zhvilluar gjërat tregon se nuk ka pasur trillime apo nxitje të dëshmitarit, i cili ia ka dhënë deklaratën Policisë vetëm pasi që rastësisht e ka mësuar identitetin e personit të cilin e kishte parë më 28 Shtator në vendngjarje.

Shkurt, të gjitha indikacionet drejtojnë kah siguria e deklaratave të dëshmitarëve Omega dhe Theta, si dhe Muca dhe Ajeti; deklaratat e Baftiut i japin motivin dhe shpjegimin e arsyeshëm tërë tregimit.

Pasqyra në të cilën bashkohen dëshmitë e ndryshme është homogjene dhe në harmoni. Ajo përfaqëson kryerjen e vrasjeve të shumëfishta më 28 Shtator 2007 në Lepenc nga ana e të dy të akuzuarve Shpend Qerimi dhe Besnik Hasani, me qëllim që të eliminohet një informator i mundshëm për vendosjen e bombës në Prishtinë e cila kishte ndodhur disa ditë më herët.

Në anën tjetër, arsyetimet që trupit gjykues ia kanë ofruar të akuzuarit mbi praninë e tyre në afërsi të vendngjarjes menjëherë pasi që ka ndodhur rasti, nuk janë të besueshme.

Shpend Qerimi ka shpjeguar që ai ka qenë duke e hetuar një rast; për këtë arsye ai u ngut që të kontaktojë Besnik Hasanin vonë natën me qëllim që ta pyet për emrin dhe numrin e telefonit të një gruaje “e cila kishte kontakte me krimin e organizuar, posedimin, shpërndarjen e narkotikëve”¹. *Ca vai sans dire*, ky person që ishte pikë kontakti është identifikuar vetëm si “X”. Pas marrjes së informatave të kërkuara prej Besnik Hasanit nëpërmes sms-së², këta dy janë takuar dhe urgjenca e hetimeve, aq e madhe sa që u deshtë që të bëhen në mes të natës, u zhduk. Me sa duket ishte një çështje edhe më urgjente, nevoja për të gjetur të holla për Shpend Qerimin, i cili “nuk e ka gjendjen e mirë” dhe “ka qenë duke e rinovuar një banjo” (Besnik Hasani, f. 34). Dhe, fatmirësisht për Qerimin, vendi ku ata janë takuar ka qenë afër shtëpisë së një borxhliu të Besnik Hasanit dhe pasi që “nuk ka qenë vonë që të shkojmë për ta takuar atë” (Besnik Hasani), ata e kanë vizituar këtë person (emri i të cilit mbeti i panjohur, Qerimi e ka përmendur nofkën e tij, “Bager”).

Për mëdyshjet e kryetarit të trupit gjykues në lidhje me rrethanat e çuditshme për mbledhje të informatave hetuese dhe për marrjen e të hollave, është përgjigja në vijim (f. 18):

Shpend Qerimi: Unë nuk kam kohë të paracaktuar për të pranuar informata, ato vijnë kur të vijnë, dhe sa i përket asaj që ne kemi shkuar te ky person natën është shumë e vërtetë që për ndërkombëtarët...(ndërpritet)

Kryetari i Trupit Gjykues:...Ky justifikim del secilën herë që ju nevojitet një justifikim për diçka.

Shpend Qerimi: Unë nuk kam thënë që nuk e di. Unë isha duke thënë që në kulturën tuaj para se që të shkoni në shtëpinë e dikujt ju e informoni atë person. Në vendin tim, kur dikush që unë e quaj shok vjen në shtëpinë time në tre të mëngjesit, kjo ndodh.

Ta mendojmë këtë këmbim për një moment.

a) Sa i përket mëdyshjeve të kryetarit të trupit gjykues sa i përket kohës për hetime, Qerimi përgjigjet që nuk ka ndonjë orar për të “marrë informata” dhe që “ato vijnë kur të vijnë”. E besueshme?

¹ Seanca 3 Shtator 2009, f. 17

² Qerimi: “Besnik Hasani është përgjigjur në mesazhet e mia por pasi që kjo ishte sekrete unë kam kërkuar që ta takoj atë dhe ne i kemi shkëmbyer informatat”. F. 17.

Në një përgjigje në mëparshme Qerimi ka thënë që ai ishte duke i kërkuar hollësitë për një grua që ka lidhje me krim të organizuar. Pra, fjalia “vijne kur të vijne” çon në drejtim të gabuar, sepse e jep përshtypjen (e gabuar) që e ka shtytur atë përderisa ajo nuk ka “arritur te ai”. Me fjalë tjera, ka qenë një hetim i zakonshëm. Për të cilin nuk ka pasur kurrfarë nevojë reale për të vepruar në mes të natës.

b) Ky përfundimi i fundit konfirmohet nga sjelljet pasuese të Qerimit. Në vend se të vazhdoj hetimet, ai pastaj shkon së bashku me Hasanin që ti merr të hollat dhe pastaj shkon në shtëpi.³ E hetimet, që ishin aq urgjente?

c) Mbi marrjen e të hollave, pse ishte aq urgjente që të kërkohen të hollat në mesnatë? A nuk mund të priste Qerimi deri në mëngjes të nesërmen? Dhe për më tepër, si mund të jetë e besueshme që në një shoqëri rurale siç është Kosova (veçanërisht në zonën ku kanë ndodhur këto veprime) të jetë normale që pas mesnatës të vizitosh një borxhli dhe të marrësh të holla nga ai? Qerimi shpjegon (f. 18) që: “Në vendin tim, kur dikush që e quaj shok vjen në shtëpinë time në tre të mëngjesit, kjo ndodh”. Kjo fjali, vështirë e besueshme në vetvete, tregon brishtësinë e arsytimit të prezantuar nga të akuzuarit. Në të vërtetë, personi të cilin ata e kanë vizituar nuk ka qenë një shok, Qerimi atë nuk e ka njohur dhe ai ka qenë vetëm një borxhli i Hasanit (i cili asnjëherë nuk e ka përdorur fjalën shok). Përveç kësaj, përdorimi i zakonshëm i dallimeve kulturore në mes të ashtuquajturve “ndërkombëtarë” dhe “vendorë” për të arsytuar sjellje të cilat përndryshe janë të pashpjegueshme është, si në rastet tjera¹, i dobët dhe i pakuptimtë. Anëtarët e trupit gjykues janë gjykatës me eksperiencë, vendorë dhe ndërkombëtarë; ata kanë jetuar në Kosovë dhe në shtete tjera me vite të tëra; ata janë në dijeni për dallimet kulturore dhe ata i kushtojnë vëmendje atyre dhe i respektojnë ato; dhe ata janë mjaft të mençur për të ditur që një person nuk shkon për të marrë të holla në mesnatë në një fshat të largët dhe rural në zemër të Kosovës. Tentimi për ti dhënë vlerë këtij versioni është vetëm provë për mungesën e argumenteve më të mira.

Në fund, sipas mendimit të trupit gjykues, arsytimet e ofruara nga të dy të akuzuarit sa i përket pranisë së tyre në atë vend natën kur kanë ndodhur vrasjet e shumëfishta, janë vetëm trillime të pabesueshme.

Rikonstruksioni i qartë i ngjarjeve të asaj nate sjell te përfundimi për praninë e Besnik Hasanit dhe Shpend Qerimit në vendngjarje në natën e vrasjeve të shumëfishta dhe që ato vrasje janë kryer nga ana e tyre. Ata kanë pasur motiv (të eliminohet Neshat Baftiu, i cili ka folur për pjesëmarrjen e Besnik Hasanit në vendosjen e bombës në Bulevardin Bill Clinton); ata janë parë disa minuta pas ngjarjes duke dalë në mënyrë të dyshimtë nga një rrugë anësore që çon në vendngjarje; Shpend Qerimi është parë në vendngjarje nga ana e një dëshmitari dhe më vonë është identifikuar.

Përfundimi që paraprinë (vrasjet e shumëfishta janë kryer nga Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi) është pjesë e rëndësishme e provave rrethore në shqyrtimin tonë gjyqësor.

³ Seanca 2 Shtator 2009, f. 33: Hasani: ...Ne kemi shkuar ta marrim borxhin në një Golf të cilin e ngiste Shpend Qerimi. Ne kemi shkuar në restorantin Mondit dhe kemi vazhduar më tej. Unë i kam marrë 500 Euro, Shpend Qerimi më ka lënë mua dhe pastaj ka shkuar në shtëpi.

¹ Shih, për shembull, shpjegimet e dhëna nga të akuzuarit për zakonet e ngushëllimeve për të arsytuar praninë e tyre në banesën e Adelina Ismailit në mes të natës një muaj pas vdekjes së Triumf Rizës

Nëse ata kanë marrë vendimin që ti vrasin të tretë, cila ishte arsyeja? Besnik Hasani e ka pasur shok ose së paku e ka njohur Neshat Baftiu². Në mungesë të një historie të urrejtjes në mes të dy të akuzuarve dhe ndonjëres prej viktimave në masakrën e Lepencit, i vetmi shpjegim logjik për vrasjet brutale është ofruar nga Prokurorja.

Prokurorja ka theksuar lidhjen në mes të krimit të 24 Shtatorit në Prishtinë dhe krimit të 28 Shtatorit në Lepenc sepse një prej viktimave të krimit të dytë (Neshat Baftiu) ka pasur informata për krimin e parë dhe ia tregonte ato njerëzve përreth.

4. Përgjimet telefonike dhe provat tjera teknike.

Përgjimet telefonike dhe provat tjera teknike kanë furnizuar elementet e mëtejme të vlerësimit.

Në këtë shqyrtim gjyqësor, përgjimet telefonike janë të dobishme, për të vendosur faktet e ndryshme në një lloj skenari dhe, së dyti, për të verifikuar disa pretendime të pandehurve; së treti, ato e mundësojnë vlerësimin e kredibilitetit të disa dëshmitarëve, duke shfaqur qëndrimin e tyre të vërtetë ndaj procedurës gjyqësore.

Duke filluar nga pika e fundit, përmbajtja e sms-ve dhe e thirrjeve telefonike në mes të anëtarëve të familjes Ismaili shfaq çiltërsinë dhe mënyrën e drejtpërdrejtë të bisedave në mes të katër grave dhe përbën një hedhje poshtë të habitshme të besueshmërisë së deklaratave të dhëna nga E dhe Z në gjykatë. Në të vërtetë, ato vërtetojnë që niveli i mirëbesimit në mes të nënës në njërin anë dhe vajzave në anën tjetër ishte i lartë. Ato përgjime e bëjnë të pamundur që të besohet që çështjet aq relevante siç janë (i) vendosja e bombës, (ii) pjesëmarrja në të e tre individëve që ishin duke e vizituar atë familje në atë kohë, (iii) natyra e marrëdhënies në mes të Adelinës dhe Besnik Hasanit, (iv) marrëdhëniet me Enver Sekiraqën dhe shumë të tjerë nuk janë diskutuar në familje. Fakti që E dhe Z vazhdimisht kanë refuzuar që të pranojnë rrethanat e tilla dhe kanë qenë fjalëpakë gjatë tërë marrjes së tyre në pyetje, ndriçon qartë besueshmërinë e pakët të dëshmitarëve të tyre. Në një mjedis aq të vogël¹, me një nënë që brengoset tepër për vajzat e saj², që tenton të kontrollojë jetën e tyre³, që vuan nga një lloj fiksimi që të telefonojë dhe të fletë, është thjeshtë e paqëndrueshme që ato çështje nuk janë diskutuar në shtëpi. Tentimi i tyre që të fshehin atë që do të ishte një qartazi temë e bisedës në çfarëdo mjedisi familjar (për shembull, natyra e marrëdhënies së motrës Adelinës me kolegën e ish të fejuarit i cili ishte vrarë dhe sulmit mbi restorantin e të dyshuarit kryesor për vrasjen) tregon qartë dashjen e tyre që të mos kenë asgjë të bëjnë me shqyrtimin gjyqësor dhe të

² Dëshmitari A B, seanca 19.509, f. 16.

¹ Kryetari i Trupit Gjyqësor: A mund të na jepni një përshkrim të përafërt të shtëpisë tuaj? Sa dhoma? Pra, ju e keni dhomën e juaj?...Dhe Adelina Ismaili e ka dhomën e saj?

Ema Ismaili: Jo, Adelina Ismaili ka qëndruar në të njëjtën dhomë me mua...Ne i kemi tri dhoma por ne nuk e përdorim njërin prej tyre. Është tepër e vogël...Zanfina Ismaili dhe nëna ime flejnë në dhomën e ditës.

² Mona Ismaili, f. 8: "...Unë jetoj me tri vajza në shtëpinë time, pa asnjë burrë në shtëpi." Në mes paragrafëve të tjerë të ngjashëm.

³ Ema Ismaili, f.27, pjesa e fundit.

akuzuarit, që të distancohen nga të akuzuarit, që të zbusin fuqinë e deklaratave të nënës së tyre dhe rolin e saj në procedurë.

Në anën tjetër thirrjet telefonike janë një parametër i mirë për vlerësimin e saktësisë së deklaratave të akuzuarve të njëjtë, dhe posaçërisht të Besnik Hasanit.

Në këtë mënyrë shfaqet që Besnik Hasani ka pasur një lidhje dashurie, të natyrës seksuale, me A Ismailin. Kjo është e pakontestueshme, dhe është thjeshtë e pakuptimtë pse i akuzuari në mënyrë aq të fuqishme e ka kundërshtuar të vërtetën e qartë. Lista e gjatë e përgjimeve telefonike dhe sms-ve të këmbëra në mes të A Ismailit dhe Besnik Hasanit është e bashkangjitur me raportin në faqen 2810 të vëllimit 9. Deklaratat e shumëfishta të Adelinës për dashurinë ndaj Besnikut, frika që ka mbetur shtatzëne (f.2814), nofkat e përdorura (“a mund ti puthë buzët e ujkut” – sms në f. 2815) e bëjnë të qartë natyrën e lidhjes në mes të këtyre dyve.

Fuqia e lidhjes në mes të Besnik Hasanit, Adelinës dhe, në përgjithësi, të gjithë anëtarëve tjerë të familjes Ismaili është e dokumentuar mirë me një numër të madh të sms-ve dhe thirrjeve telefonike të këmbëra në mes të Hasanit, Adelinës, Monës dhe Emës në muajt Shtator, Tetor dhe Nëntor.

Çfarë lloj lidhje ishte kjo? Siç sugjeroi Prokurorja, a ishte një përdorim i thjeshtë i një zonje në moment të dobësisë, me qëllim që të mblidhen informata për ish të dashurin e saj (Enver Sekiraqa)?

Në parim, pyetja mund të ketë rëndësi, pasi që një përgjigje pozitive mund të hedh dritë mbi arsyetimin e sjelljeve të Besnik Hasanit dhe mund të ndihmojë në vendosjen e mozaikut të ngjarjeve në vendin e duhur.

Megjithatë, trupi gjykues është i mendimit që edhe nëse konfirmohet prerazi që Besnik Hasani kalonte me A Ismailin për qëllimet e tija jo-sentimentale, kjo nuk do të ndikonte dukshëm në pasqyrën e krijuar.

Me sa duket është e vërtetë ajo që vet i akuzuari e ka thënë gjatë marrjes së tij në pyetje përpara Prokurores¹: “Unë kam shumë të dashura por Kaltrinën (Selmani) e dua”. Ky përshkrim i jetës së Hasanit është shfaqur qartë nga shumë burime², pra zotësia e tij që të luaj në fusha të ndryshme dhe të mbajë lidhje të ndryshme. Ai e pranon këtë dhe është krenar për këtë, si një shenjë të burrërisë së tij.

Kjo me siguri e shfaq një anë të karakterit të tij, që vë në pah dykuptimësinë e sjelljeve të tij. Një dykuptimësi që është *lajtmotivi* i tij dhe karakteristikë e tij dhe që shpjegon tendencën e tij që të gjej arsye dhe të gënjej³. Një anë e karakterit të tij e cila ka peshë në vlerësimin e alibisë së tij, siç do të shpjegohet më vonë.

Në anën tjetër, rrethana që i akuzuari në mesin e të dashurave të tij i ka përmendur dy ish të dashura të Enver Sekiraqës nuk mund të merret si ko incidencë e çuditshme. Më tepër

¹ 12 Shkurt 2008, f.10, vëll.6, f. 1881

² Dëshmitari Rasim Berisha, seanca 30 Qershor 2009, f. 17: “Ndonjëherë ka ardhur me një vajzë për pushim dhe ndonjëherë për tërë natën”.

Deklarata e Fikri Hasanit, e pranuar si provë ex. Neni 368 KPPK, Vëll.6, f. 1920.

³ Cfr. Marrje në pyetje e Besnik Hasanit në Gjykatë, 2 Shtator 2009, f.25.

është një tregues i interesit të akuzuarit që të ketë një dituri për rrethin e Enver Sekiraqës. Dhe ky përfundim fare nuk e ndryshon natyrën e marrëdhënies në mes të A At dhe Enver Sekiraqës (seanca 25.5.09, f.28: A A: “Unë kam qenë në lidhje (me Sekiraqën), por kundër dashjes sime.”). Përkundër refuzimit të tij që ta pranojë këtë, lidhja e tij me A An ka filluar me iniciativë të tij në kohën e shqyrtimit gjyqësor në të cilin Enver Sekiraqa ka qenë i akuzuar për detyrim të A At⁴. Dhe lidhja e tij me Adelinën ka filluar vetëm disa javë pas vdekjes së Triumf Rizës, përkundër kundërshtimeve sa i përket kësaj lidhje, për shkak të turpit të qartë të së pasurit lidhje me një zonjë (përveç kësaj, personalitet i njohur) aq pak kohë pas vrasjes së të dashurit të saj (një polici të mirënjohur dhe vlerësuar). Kundërshtimet janë të dokumentuara mirë në dëshminë e M Ismailit (e cila flet për komentet në lagje), në deklaratën e Fikri Hasanit me datë 11.4.08 (vëllimi 6, f. 1821: Unë e kam këshilluar që mos të del më me atë (A Ismailin)”...”Unë gjithashtu e kam këshilluar në atë kohë që nëse shoqërohet me A Ismailin, ai nuk do të jetë shoku im, pra për atë arsye marrëdhënia u zbutë pak dhe ne nuk e kemi pasur lidhjen e rregullt si normalisht”) dhe kjo konfirmohet nga vendimi i Adelinës, në atë kohë, që të ndërrojë vendbanimin e saj, kur ka shkuar që të jetojë në shtëpinë e dajës së saj. Vet Besnik Hasani ka qenë i vetëdijshëm për komentet (marrja në pyetje përpara prokurores f. 1878).

Për këtë, Besnik Hasani përgjigjet që interesimi i tij ndaj Adelinës i ka pasur dy arsye të ndryshme. Së pari, për ti shprehur ngushëllime¹ të fejuarës së një kolegu trim, i cili besohej të ketë qenë viktimë e një gangsteri. Së dyti, sepse ai e ka njohur atë që nga më parë dhe ai ka pasur një interes në lidhje me profesionin e Adelinës si këngëtare.

Asnjëri prej dy arsyetimeve nuk është i besueshëm.

Në Kosovë, si gjithkund tjetër, ngushëllimet shprehen jo gjatë pas vdekjes së personit të afërm. Trupi gjykues është në dijeni për zakonet vendore në lidhje me shprehjen rituale të respektit dhe solidaritetit me familjen e personit të ndjerë. Nuk është e pazakonshme të shihet, në Prishtinë ose në vende tjera në Kosovë, një karrige e mbuluar me një peshqir të bardhë, e vendosur përjashta shtëpisë së të ndjerit. Mundësia që personat të shkojnë për vizitë zgjatë një javë, sipas traditave, përveç nëse personi është shok ose i afërm i familjes. Nuk është e vërtetë ajo që ka deklaruar Shpend Qerimi, që vizita mund të bëhet më vonë ose që mund të përsëritet³. Nuk është e vërtetë që vizita për ngushëllime mund të bëhet vonë natën (siç pohohet në lidhje me vizitën e 22 Shtatorit 2007) veçanërisht nëse kjo do të thotë që duhet shkuar në shtëpinë e katër grave. Siç është cekur tashmë (f.30), trupi gjykues konfirmon përshtypjen e tij që traditat dhe dallimet kulturore përmenden në mungesë të argumenteve më të mira, në bindjen që gjykatësit duhet ti pranojnë argumentet më të pabesueshme.

⁴ Seanca 25.5.09, f.30: Ardiana Ahmeti: ...është e vërtetë që unë nuk e kam njohur Besnik Hasanin para asaj date. Dhe pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor unë i kam njoftuar policët dhe pastaj kam filluar të shoqërohem me të. Pastaj pas një kohe ne kemi filluar një lidhje. Prokurorja Publik: Pra ti atëherë ke filluar që të mbash lidhje me të? Ardiana Ahmeti: Jo, unë nuk e kam thënë këtë: ai ka filluar të tentojë të më afrohet. Unë u njoftova me të.”

¹ Seanca 2 Shtator 2009, f. 33: Vahide Braha: Kur ke thënë që ke shkuar te Mona Ismaili është më mirë të thuhet që ke shkuar te Adelina Ismaili. Sa kohë ke qëndruar atje? Besnik Hasani: Jo gjatë, vetëm për ngushëllime, shumë policë të SHPK-së kanë qenë aty së bashku me gjykatës dhe SHPK.

³ Mbi vizitat e përsëritura, Qerimi cekë: “Ne kemi shkuar dy, tre ose katër herë për të shprehur ngushëllime, pasi që feja Myslimane thotë që sa herë që të shkosh për të shprehur ngushëllime, kjo është një gjë e mirë për shpirtin tënd.”

Me një rast tjetër, kur është marrë në pyetje përpara Prokurorjat më 12 Shkurt 2008 Besnik Hasani ka shpjeguar që vizitat e tij në shtëpinë e A Ismailit kanë pasur një arsyetim tjetër. Në fakt, në pyetjen e Prokurores: “Pasi që ti më ke thënë që nuk ke qenë shokë i ngushtë (i Adelinës), pse ke shkuar në shtëpinë e Adelinës për ti shprehur ngushëllime?”, i akuzuari është përgjigjur: “Prej një kushëriri tim, e kam njohur nënën e Adelinës dhe vëllai im ka bërë muzikë në Gjermani dhe unë e kam kontaktuar nënën e Adelinës ashtu që A të shkojë dhe të këndojë në Gjermani”. Tani, në të gjitha transkriptet dhe tekstet e sms-ve nuk është asnjë paragraf që mund të konfirmojë versionin e Besnik Hasanit. Askund nuk përmendet që A mund të ketë pasur kontakte profesionale me një kushëri të Besnik Hasanit në Gjermani apo diku tjetër. Kjo ka qenë vetëm një shpikje e Besnik Hasanit, tërësisht e pabazë. Në anën tjetër, është vështirë që të besohet që, gjatë vizitës në shtëpinë e të fejuarit të një kolegu të ndjerë për të shprehur ngushëllime, dikush do të fillonte të fliste për mundësinë e angazhimeve profesionale në Gjermani.

Me të njëjtën teknikë, i akuzuari ka tentuar që të hedh poshtë pretendimin e prokurores për armiqësinë dhe rivalitetin e tij me Enver Sekiraqën.

Pretendimi bazohet në disa fakte të cilat janë konfirmuar në shkallë të konsiderueshme në shqyrtim gjyqësor.

Së pari, deklarata e M Ismailit përpara Prokurores, e lexuar në Gjykatë ex neni 364 KPPK duke marrë parasysh përmbajtshërinë e dëshmitares. Në atë deklaratë, M Ismaili ka përmendur një ngjarje kur ajo ka ndihmuar në rrahjen e dy infermiereve nga ana e Besnik Hasanit dhe vëllait të tij. Arsyeja për rrahjen ka qenë afërsia e infermiereve me familjen apo rrethin e Enver Sekiraqës.¹

Së dyti, në pjesën e parë të dëshmisë së A At (rrethanat e arrestimit të Enver Sekiraqës nga ana e Besnik Hasanit dhe anëtarëve të tjerë të ROSU të Ferizaj në 2006).

Së treti, nëpërmes pranimit të Besnik Hasanit në deklaratën e tij përpara Prokurores dhe në Gjykatë.

Në dëshminë e tij të 12 Shkurtit 2008, ai ka marrë cekur që ai ka qenë në dijeni për qëllimin e Sekiraqës që ta vret atë edhe nëse gjithashtu ia ka atribuuar këtë vizitave të tij të përsëritura në shtëpinë e A Ismailit pas vdekjes së Triumf Rizës (por kërcënimet i kanë paraprirë vizitave të përsëritura, duhet vërejtur); Në gjykatë, ai ka mohuar ndonjë kundërshti me Sekiraqën, duke deklaruar që kjo do të kishte qenë e mospërputhshme me etikën e një polici.

¹ “Unë e kam parë Besnik Hasanin për herë të parë në jetën time kur ai e ka shkelmuar një infermiere në mënyrë shumë të dhunshme dhe vëllai i Triumfit e kapi për qafe një infermiere tjetër, Besnik Hasani dhe shokët e tij të policisë ia kanë marrë telefonin këtyre infermiereve. Unë kurrë nuk kam parë dhunë të tillë në jetën time” Kjo ishte pasi që kufoma e Triumfit është sjell në spital.” Prokurorja: “Cila ishte arsyeja për këtë dhunë?” Mona: “Unë nuk e kam dëgjuar Besnikun duke thënë ndonjë gjë, por e kam dëgjuar vëllain e Triumfit duke thënë “ju kurva të Sekiraqës, unë e kam parë Besnikun duke e shkelmuar njërin prej infermiereve me aq urrejtje sa që e di që e ka urrejtur Enver Sekiraqën aq shumë”...”Sa herë që ka ardhur Besnik Hasani në shtëpinë tonë, ai thoshte si e ka rrahur keq Enver Sekiraqën, dhe si e ka bërë një incizim të fytyrës së shtrembëruar të Enver Sekiraqës pasi që e ka shkelmuar me çizmet e tij, dhe këto incizime i janë shpërndarë njerëzve të ndryshëm nëpërmes telefonit. Pas vdekjes së Triumf Rizës, Besnik Hasani dhe shokët e tij kanë shkuar në Vranjevc, në lagjen ku jeton Enver Sekiraqa, dhe i kanë rrahur pleqtë, gratë dhe fëmijët, dhe Besnik Hasani mburrej për këtë.”

Së katërtri, kërcënimet e dokumentuara plotësisht kundër Besnik Hasanit nga bashkëpunëtorët dhe ndihmësit e Enver Sekiraqës.

F.2670 e Vëllimit 9 njofton për një thirrje telefonike që Besnik Hasanit ia ka bërë Hysen Kamberi më 7 Maj 2007, ku përmenden kërcënimet dhe mundësia e një përlëshje në mes të anëtarëve të grupit të Sekiraqës, në një rën anë, dhe Kamberit dhe të tjerëve, në anën tjetër.

Shpend Qerimi ka konfirmuar në Gjykatë që ai personalisht e ka informuar Besnik Hasanin për rrezikun nga një sulm kundër jetës së tij, që nisej nga Enver Sekiraqa. Në fund, edhe para vdekjes së Triumf Rizës, Besnik Hasani i ka raportuar kërcënimet nga Burim Aliu, një bashkëpunëtor i Enver Sekiraqës².

Së pesti, mesazhi i “urimit” i dërguar nga S K për në telefonin e Besnik Hasanin mbrëmjen e 24 Shtatorit 2007 në ora 19.36 dhe deklarata e policit të njëjtë, kolegë i Besnik Hasanit, e dhënë përpara hetuesve më 3 Mars 2008 (Vëllimi 5, f. 1553) dhe në Gjykatë më 14 Maj 2009 (f.24). Tani, në bazë të tekstit që Kamishi ia ka dërguar Hasanit dhe në bazë të përgjigjes që ai e ka marrë nga Cena dy minuta më vonë (“mos shkruaj më në këtë telefon, Cena”), nuk mund të vërtetohet me siguri që Kamishi ka qenë në dijeni për qëllimin apo planin specifik sa i përket vendosjes së bombës; por ky mesazh është provë e drejtpërdrejtë që armiqësia e Besnik Hasanit ndaj Enver Sekiraqës dhe rrethit të tij ka qenë e njohur në mesin e policëve në rajoni e Ferizajit dhe Hanit të Elezit. Nuk është e besueshme që mesazhi i është drejtuar një polici tjetër sepse “ne (policët) e urrejmë atë, e tërë SHPK-ja e urren atë sepse ai është një kriminel në Prishtinë” (deklarata e 3 Marsit 2008). Dëshmia e paqartë dhe bishtnuese e S Kt edhe në Gjykatë edhe në hetuesi (deklarata është lexuar në Gjykatë ex Neni 364 KPPK, për ta përkujtuar dëshmitarin, i cili qartazi tentonte që mos përgjigjej) nuk mund të fsheh pohimin e tij sa i përket kundërshtisë së qëndrueshme në mes të Hasanit dhe Sekiraqës. Dëshmitari ka ditur për to, i ka ditur arsyet për to, dhe i ka lidhur ato me shpërthimin.

Të gjitha këto fakte puqen në drejtim të përfundimit që në muajt në mes të Majit 2006 (arrestimi i Sekiraqës) dhe Shtatorit 2007 ka pasur një ngritje të tensionimeve në mes të Besnik Hasanit (dhe ndoshta edhe policëve tjerë nga Ferizaji) në një rën anë, dhe Enver Sekiraqës dhe rrethit të tij, në anën tjetër. Besnik Hasani i ka kontribuar edhe më tej këtij tensionimi kur ai është lidhur së pari me A An dhe pastaj me A Ismailin, të cilat të dyja kishin pasur lidhje me Enver Sekiraqën.

“Vjedhja” e të fejuarës me siguri është kuptuar si një provokim. Nëse bëhet dy herë, është një ofendim, një akt arrogance, një sfidim. Në një mjedis të vogël siç është Ferizaji, kjo nuk ka mundur të kalojë e pavërejtur. Rrethana që këtë e ka bërë një polic e ka bërë sfidimin të patolerueshëm.

Në përfundim, gara për kontrollin e territorit dhe gara për femra janë baza e ballafaqimit në mes të Besnik Hasanit dhe Enver Sekiraqës.

² Marrja në pyetje përpara prokurorjat, 12 Shkurt 2007: “Ai më ka kërcënuar edhe mua dhe më ka thënë si je Besnik – sepse ai është i njohur për gjëra të ndryshme si të qëlluar me armë zjarri – dhe pastaj ai më është afruar dhe ka thënë unë e di që ti pse nuk je duke folur me mua, dhe unë e kam pyetur pse dhe ai ka thënë ti je shok i Triumfit dhe unë jam shok i Enverit. Pastaj, ai më ka thirrur në telefon dhe më ka quajtur gjëra të këqija”.

Në mënyrë paksa pikante, mund të shtohet që është njohuri e përgjithshme dhe është vërejtur nga shumë që këta të dy edhe përngajnë në pamje dhe në mënyrën si sillen.

Të shkurtër por në gjendje të mirë fizike dhe të fortë, ata shprehin një model të mashkullorësisë që bazohet më shumë në energji dhe dinamizëm se sa mbi të menduar dhe sofistifikim intelektual. Te ta mund të gjenden edhe këto tipare identike: shprehja e vetëbesimit (në Gjykatë, Besnik Hasani ka dominuar mbi të dy të akuzuarit tjerë, dhe, kohë pas kohe, edhe mbi avokatët e tij; ai ka buzëqeshur me krenari kur janë përmendur lidhjet e tij seksuale), joshja për guximin ushtarak¹, një stil i veshjes që përbëhet nga kravata të shquara dhe këmisha të bardha si bora ose këmisha që përputhen, të veshura me rroba ngjyrë hiri me shkëlqim ose me rroba me vija; modeli i njëjtë i flokëve, flokë të shkurta të zeza të krehura prapa dhe të bëra më xhel. Ata edhe ngasin tipin e njëjtë të veturës (Mercedes të zezë, pa pasur nevojë të ceket).

Të gjitha këto karakteristika shfaqen lehtë (për Besnik Hasanin, në Gjykatë; për Enver Sekiraqën, ai është figurë e njohur në Kosovë dhe fotografitë e tij mund të gjenden lehtë në internet, për shembull) sepse ato shprehen nga të dytë, në të njëjtën mënyrë. Ata dëshirojnë të përçojnë idenë e njëjtë të burrit të fuqishëm, që kontrollon situatën. Një burrë dominues, që tërheq vëmendje dhe respekt për rolin e tij dominues. Si për kafshë, është e qartë që në territorin e njëjtë (Ferizaj), nuk mund të bashkekzistojnë dy të tillë të tipit të njëjtë.

Manipulatorë të shkëlqyeshëm të vartësve, të cilët kanë tendencë që të kopjojnë eprorin e tyre (siç dukej që bënte Shpend Qerimi në Gjykatë), ata janë të prirë që të krijojnë iluzione për të nxjerr konsensus ose për të arsytuar sjelljet e tyre (Hasani gënjente në mënyrë të përsëritur në Gjykatë, edhe përkundër të gjitha provave). Zemërgjerë dhe shpirtmëdhenj sa i përket disa gjërave¹, ata tentojnë që të personifikojnë modele të kulturës së popullarizuar që e kanë mësuar në filma më shumë se në libra (polici i stilit të De Niro-s, gangsteri i viteve të tridhjeta). Modele të cilat janë në këtë kohë të vjetruara dhe qesharake në pjesët tjera të Evropës por që ende janë tërheqëse në Ballkan.

Si heronjtë e tyre, ata janë të zotë për çfarëdo veprimi, të lavdishëm apo të neveritshëm, për të arritur atë që ata e perceptojnë si diçka që e konsolidon pushtetin e tyre. Ata mund të vrasin rivalin (Triumf Riza) ose mund të vendosin një bombë edhe pse me këtë rrezikohet që të vriten edhe të tjerë.

Analiza e lëvizjeve të akuzuarve natën e 23/24 Shtatorit 2007 nëpërmes shënimeve të përgjimeve telefonike (dhe lokacionit të celulare GSM), nuk ka paraqitur prova përfundimtare.

Gjatë tri seancave dëshmitari D T dhe dy teknikë të PTK-së (Ardian Grezka dhe R Sh) të thirrur me kërkesë të avokatëve mbrojtës, janë përgjigjur në një ortek pyetjesh të palëve dhe të trupit gjykues, duke shpjeguar mënyrën e hetimeve si dhe shumë lloje të aspekteve

¹ Shih fotografitë e Besnik Hasanit duke mbajtur një armë automatike MP5, Vëllimi 9, f. 2704-6

¹ Hasani është gjithmonë i gatshëm për ti dhënë të holla hua Qerimit; ai e kupton nevojën e shokut i cili “nuk është në situatë të mirë” dhe “që gjithmonë i nevojiten të hollat”

teknike. Marrja në pyetje e këtyre dëshmitarëve ka zgjatur disa orë, në tentim që të sqarohen edhe aspektet më të qarta (“A mund të gjendet vendndodhja e një telefoni me anë të sistemit, nëse ai është i fikur”, është një pyetje që është bërë në mënyrë të përsëritur).

Marrja në pyetje e dëshmitarit D T ka qenë thelbësore për kuptuar raportet mbi thirrjet telefonike dhe për ti vendosur ato në kontekstin e duhur; marrja e tij në pyetje gjithashtu e ka mundësuar trupin gjykues që të vërtetojë saktësinë e procedurës së ndërmarrë. Megjithatë, sa i përket vendndodhjes së të akuzuarit në natën kritike, e vetmja rrethanë relevante që është zbuluar ishte numri (abnormal?) i thirrjeve telefonike dhe sms mesazheve të shkëmbyera në mes të akuzuarve dhe (në favor të akuzuarit Cena, siç do të ceket më vonë) një thirrje telefonike e bërë nga telefoni i Nusret Cenës në ora 1.36 të mëngjesit më 24 Shtator dhe të regjistruar nga celula telefonike me vendndodhje në...

Nuk mund të shtohet asgjë tjetër. Nuk ka kurrfarë regjistrimi të celulave që do të lejonte përcaktimin e vendndodhjes së ndonjërit prej të akuzuarve në afërsi të vendngjarjes në kohën e ngjarjeve.

Edhe analiza e regjistrimit të udhëtimeve (trip ticket) të automjeteve zyrtare të njësisë policore të cilës i përkiste Besnik Hasani dhe e dokumentacionit që ka të bëjë me praninë e tij në ditët në fund të Shtatorit 2007 nuk ka paraqitur prova përfundimtare. Regjistri i udhëtimeve (trip ticket) i automjetit 093 KS 073 dukej pas një ekzaminimi të thjeshtë të ketë qenë i ndryshuar dhe me indikacione të papajtueshme. Përkundër asaj që e kanë thënë policët e ngarkuar me detyrën që të kontrollojnë dokumentacionin (oficeri i transportit dhe polici administrativ), është e qartë që mundësia për të manipuluar me dokumentacionin, po ta kishte dikush për qëllim që të bëjë këtë, ishte e papenguar. Dëshmitë bishtnuese dhe të pakuptueshme të së gjithë policëve të marrë në pyetje në lidhje me këto aspekte dhe rrethana që disa prej tyre mund të kenë luajtur ndonjë rol në ngjarjet, e bën të kotë çfarëdo rikonstruksioni në lidhje me atë dokumentacion.

Shënimet e nxjerra nga regjistri i udhëtimeve (trip ticket) dhe nga orari/ndërrimi i punës (Vëllimi 8, f. 2364) nuk mund të përdoren në dëm të akuzuarit, për të vërtetuar përgjegjësinë e tij për pjesëmarrjen në vendosjen e bombës në Bulevardin Bill Clinton. Por ato nuk mund të përdoren as në favor të akuzuarit, duke thënë për shembull që Besnik Hasani ka qenë në pushim mjekësor, ose pasi që është dokumentuar që vetura që e ka përdorur ai (093 KS 073) nuk është ngarë më shumë se disa kilometra atë ditë, është vërtetuar që i akuzuari nuk ka qenë pjesëtar i grupit që e ka vendosur bombën.

Përgjimet e dy thirrjeve telefonike të Besnik Hasanit janë shumë të rëndësishme, sipas mendimit të trupit gjykues.

Ne i referohemi thirrjeve që i akuzuari ia ka bërë M dhe A Ismailit në rastin e marrjes së tyre në pyetje përpara Prokurorjat.

Kur janë marrë në pyetje gjatë hetimeve, të dyja zonjat janë thirrur në telefon nga ana e Besnik Hasanit. M Ismaili është kontaktuar një ditë para marrjes në pyetje përderisa A është thirrur një ditë më pas.

Të dy thirrjet telefonike shfaqin interesimin e ngulët të Besnik Hasanit për atë që dëshmitaret mund ta thonë (M) ose që e kishin thënë (A). Ato e dokumentojnë dashjen e të akuzuarit që të ndërhyjë në hetime (duke tentuar që të ndikojë në dëshmitaren M) dhe të di se në cilën fazë janë ato(A). Të dy veprimet, nga ana e një polici, janë të palejueshme dhe të dyshimta.

Të palejueshme sepse një polic nuk duhet të ftoj një dëshmitare (Monën) që të mos përgjigjet. Një polic nuk duhet të ndërhyjë në hetimet që janë në zhvillim e sipër duke e pyetur një dëshmitare (Adelinën) për dëshminë e saj, duke fyer kolegët ndërkombëtarë, duke shprehur keqardhje që dëshmitarja (e cila e ka rolin e dëshmitares deri në fund të shqyrtimit gjyqësor) ka folur tepër dhe ka zbuluar emra të cilat nuk është dashtë që ti përmend.

Të dyshimta, pasi që po të kishte qenë Hasani indiferent ndaj hetimeve, ai nuk do të kishte pasur arsye që ti thërret dy zonjat dhe të sjell njërën prej tyre (Adelinën) në pozitë që të jetë gati të filloj të qaj në telefon për atë që ia ka thënë hetuesve. Besnik Hasani i ka thënë Gjykatës që ai nuk e di se në lidhje me cilat hetime kanë qenë të ftuara M dhe A nga ana e hetuesve. Ai ka shtuar që ai ka menduar që dy zonjat Ismaili janë marrë në pyetje në lidhje me vrasjen e Triumf Rizës.

E besueshme? Ky arsyetim mund të funksionoj në parim sa i përket Monës, të cilën e ka thirrur para marrjes në pyetje, por sa i përket Adelinës, e cila tashmë ishte marrë në pyetje? Dhe sa i përket Monës, pse të dekurajohet një dëshmitare nga dëshmia në lidhje me vrasjen e një polici, të fejuarit të vajzës së dëshmitares, një veprim që ka ngritur një valë neverie te popullata e Kosovës?

Gjatë kontrollit të shtëpisë së Shpend Qerimit është gjetur një uniformë e njësisë speciale. Kjo uniformë është identike me ato që i ka përdorur grupi i policëve të cilët e kanë vendosur bombën më 24 Shtator 2007. Posedimi i këtyre rrobave është arsyetuar në Gjykatë nga i akuzuari i njëjtë dhe nga një dëshmitar tjetër (ka qenë një donacion apo më mirë rroba të mbetura nga policia Amerikane e cila e kishte trajnuar njësinë të cilës i përkiste Shpend Qerimi). Natyrisht ky nuk është një indikator për pjesëmarrje në vendosjen e bombës.

Më interesante, sa i përket përdorimit të rrobave në veturat zyrtare të policisë, në sms-në e dërguar nga Fadil Sadiku te Bejtullah Mehmeti në mëngjesin pas vendosjes së bëmbsës, ku polici i parë i thotë të dytit (ata punojnë në njësinë e njëjtë të policisë) “hej shok, të lutem merri ca rroba civile, i kam lënë në veturën e Shpendit. Unë do ti marrë kur të vij për të marrë ty. Tung.”

Mesazhi tregon që Sadiku ka lënë rroba civile në veturën e Shpend Qerimit, ditën para vendosjes së bombës (e qartë nga konteksti) të cilat dëshironte ti merrte në mbrëmjen e

24 Shtatorit (Sadiku dhe Mehmeti) kur ata do të ishin në ndërrimin e natës në mes të 24 dhe 25 Shtatorit 2007.

Mbi këtë ngjarje, të përkujtuar nga Prokurorja gjatë marrjes në pyetje të akuzuarit¹, përgjigja nuk përputhej me pyetjen, në të vërtetë. Shpend Qerimi mund të mos e ketë kuptuar pyetjen ose i referohej një ngjarje tjetër.

Prokurorja Publik: Është bërë një thirrje telefonike nga Sadiku te Mehmeti në lidhje me disa rroba që janë lënë në veturën e tij. Të kujtohet kjo?...A janë lënë rroba dhe uniforma në veturën tënde?

Shpend Qerimi: Ky Sadiku punon në ROSU. Gjatë trajnimit që e kemi pasur si polic në dhomën e stacionit të policisë në Ferizaj unë nuk i kam pasur rrobat sportive me veti, dhe i kam huazuar rrobat sportive. Pasi që ROSU Ferizaj i mban ato në stacion të policisë, pasi që ata ushtrojnë çdo ditë, unë i kam huazuar ato për tri orë për një trajnim teknik që e kemi pasur. Nuk e di, ndoshta ai mesazh ka të bëjë vetëm me faktin që unë i kam huazuar ato, por nuk ka qenë hera e parë që e kam bërë këtë.

Prokurorja Publik: Rrobat që kanë mbetur në veturë, a ishin tuajat?

Shpend Qerimi: Rrobat sportive që i kam huazuar për trajnim, trajnimin e bëjmë një herë në vit, i kam kthyer ato rroba. Unë nuk e di që ai i ka lënë rrobat në veturë.

Nga mesazhi, megjithatë, është e qartë që rrobat nuk ishin të Qerimit. Pra përgjigja nuk përputhet dhe mund të jetë pasojë e një dykuptueshmërie.

Megjithatë, kuptimi i tekstit është i qartë dhe ai peshon kundër të akuzuarit, pasi që hedh poshtë versionin e tij që ai ka qenë në një turnir futbollit një natë më parë dhe sugjeron që ai ka qenë i shoqëruar nga Fadil Sadiku i cili i ka ndërruar rrobat e tij civile. Pse? Për të marrë pjesë në një turnir futbollit? Po të kishte qenë i pranishëm Fadil Sadiku dhe po të kishte marrë pjesë në turnir, Qerimi me siguri nuk do të kishte harruar që ta përmend atë në alibinë e tij.

Prova relevante rrjedhin edhe nga ekzaminimi i mostrave të marra nga vetura policore të cilën e ka përdorur Besnik Hasani në kohën e ngjarjeve.

Siç dihet, rezultatet e dërguara nga institucioni të cilit iu kishte bërë kërkesa në Gjermani kanë konfirmuar praninë e gjurmëve të eksplozivit në veturën e policisë 093 KS 073.

Dihet edhe që mostrat janë marrë disa muaj pas vendosjes së bombës dhe që ekzaminimi i parë, i kryer nga një institucion tjetër në një shtet tjetër, kishte rezultuar negativ.

Rezultatet e verifikimit teknik janë kontestuar nga avokatët mbrojtës me një kërkesë të paraqitur më 10 Korrik 2009 për disa arsye që mund të përmbledhen një këtë mënyrë: (i)

¹ Seanca 3 Shtator 2009, f. 14

pranueshmëria e ekzaminimit pa një urdhër të gjykatësit të procedurës paraprake; (ii) siguria e rezultatit.

Trupi gjykues, me vendimin e datës 23 Gusht, i cili i është lexuar palëve gjatë seancës së 26 Gushtit 2009, ka refuzuar kundërshtimet e avokatëve mbrojtës duke vërejtur mbi çështjen e pranueshmërisë që *“neni 153 KPPK cekë, në mënyrën më të qartë dhe të thjeshtë, që “provat e marra në shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu”. Në rastin e kallëzuar nga avokatët mbrojtës, një ekspertizë e siguar pa autorizim të mëparshëm të gjykatësit të procedurës paraprake, të supozuar si të domosdoshëm, nuk ekziston asnjë dispozitë, në kodin e procedurës e as diku tjetër, që e sanksionon shkeljen e supozuar si të papranueshme. Me fjalë tjera, papranueshmëria parashihet vetëm në raste specifike.*

Përveç kësaj, trupi gjykues gjithashtu ka vërejtur që në sistemin e kodit procedural të Kosovës, prokurorit, në përgjithësi, nuk i nevojitet një autorizim paraprak i gjykatësit të procedurës paraprake, për të thirrur një dëshmitar ekspert ose për të kërkuar një ekspertizë.

Në të vërtetë, autorizimi paraprak i gjykatësit të procedurës paraprake mund të kërkohej kur përfshihen disa ekzaminime specifike, si *post mortem*, ekzaminim fizik, analizë ADN ose ekzaminim molekular (neni 237.2 KPPK). Për ndërhyrje potenciale në privacinë e subjektit që duhet ekzaminuar ose për arsye tjera të rastit, në ato raste kërkohej intervenimi i një gjykatësi, për të vlerësuar nevojën dhe limitet në të cilat ndërhyrja në sferën e privacisë të personit është në pajtueshmëri me nevojat e drejtësisë. Por gjithashtu në këto raste, siç është përcaktuar në pjesën e fundit të dispozitës, kur nuk ekziston nevoja për drejtpeshim të kujdesshëm në mes të nevojave kontradiktore, sepse pala e dëmtuar ose i dyshuari e jep pëlqimin e tij, ligji nuk kërkon intervenimin e gjykatësit të procedurës paraprake.

Në rastin tonë, ku mostrat janë marrë nga ulëset e veturave, nuk ka pasur asnjë ndërhyrje në privacinë e askujt; nuk është kryer asnjë ekzaminim trupor. Pra, nuk ka pasur nevojë që të kërkohej nga gjykatësi i procedurës paraprake që ai të urdhërojë analizën e kryer nga ekspertët.

Ne kemi dëgjuar nga burimi kompetent (A J) se veturat e policisë nuk transportojnë eksploziv (që në Kosovë, si gjithkund tjetër nuk është mjet i policisë) dhe se lloji i eksplozivit të gjetur në gjurmët e veturës 093 KS 073 nuk përdoret në Kosovë dhe nuk mund të gjendet në këtë vend as për nevojat civile, për të cilat përdoren lloje tjera të eksplozivit. Nitropenta (PTN) mund të gjendet në Kosovë vetëm në spangot e detonimit.

Ne bazë të kësaj informate, racionalisht, nuk ekziston mundësia e kontaminimit. I vetmi përfundim logjik është se gjurmët kanë mbetur nga sasia e eksplozivit të përdorur për shpërthim, që është trajtuar gjatë transportimit deri te vendet përkatëse të përdorimit.

Rrethana se ato janë gjetur disa muaj pas transportimit të supozuar për në vendin e krimit, si dhe fakti se ekzaminimi fillestar nuk ka arritur ndonjë rezultat, nuk ndikon në këtë përfundim.

Menjëherë pasi të përjashtohet mundësia e kontaminimit, prezenca e gjurmëve në distancë disa mujore vetëm deshmohet për saktësinë e marrjes së mostres, të profesionalizmit të laboratoreve dhe për kokëfortësinë e substancës; nëse nuk ishin gjetur gjurmët herën e parë, mund të mvaret nga aplikimi i procedurës teknike apo thjeshtë në faktin se substanca specifike nuk është kërkuar dhe se kërkimi është orientuar në drejtim të substancës më të rëndomtë eksplozive.

- - -

5. Alibia e të akuzuarit

Gjatë procesit të shqyrtimit gjyqësor të akuzuarit kanë treguar se ata nuk kanë mundur të jenë autorët e shpërthimit të bombës sepse ata gjendeshin dikund tjetër kur kjo ka ndodhur.

Ata kanë ofruar alibinë me sa vijon:

1. Besnik Hasani: Ai tha se shumicën e kohës së natës ndërmjet 23 dhe 24 Shtator 2007 e ka kaluar në shoqëri të njëjës nga dashnoret e tij, A A; Ai ka specifikuar se para mesnates ai ka vizituar shtallën e deleve të udhëhequr bashkë me Nusret Cena, në Komunën e Kaçanikut e pastaj ai ka shkuar në Hotel Europa 92 që gjendet në rrugën që shpie nga Pristina në Shkup dhe afër shtalles, ku i ka kaluar disa orë me Ardianën e pastaj ata së bashku kanë shkuar në Han të Elezit me qëllim që të kontaktojnë Buhran Shkretën në dyqanin e tij të ëmbëlsirave për të marrë disa para që i kishin dërguar disa të afërm që jetojnë dhe punojnë në Gjermani e që i kishin dërguar përmes tij; Përfundimisht, ai tha, ai u kthye bashkë me dashnore të tij në Motel Europa 92 ku kanë pirë kafe dhe në fund ai e ka shoqëruar atë në shtëpinë e saj në Ferizaj para se të kthehej në shtëpi.

E tërë alibia është e bazuar në deklaratat e A A, F C, Buhram Shkreta dhe Sabrje Saliu, të cekur si dëshmitarë nga Besnik Hasani dhe të dëgjuar më 25 Maj dhe 30 Qershor (Ardiana), 8 Qershor (F C) dhe 2 Shtator (Buhram Shkreta and Sabrje Saliu).

Dëshmia e Fehmi Cenës i cili punon si roje dhe si kultivues në shtallën e deleve/dhive, pronë e Besnik Hasanit, Nusret Cenës dhe të tjerëve, me sa duket vërtetojnë versionin e Besnik Hasanit se ai së bashku me A A e ka vizituar shtallën (e cila gjendet afër Motel Europa '92) për të vërtetuar përhapjen e sëmundjes në shtazë dhe numrin e madh të ngordhjeve që ajo iu kishte shkaktuar atyre. Mirëpo, dëshmia ia ka dhënë përshtypjen e qartë Trupit Gjyqësor se dëshmitari ka qenë i përgatitur, dhe ai iu është referuar rrethanave, për të cilat nga ai është kërkuar që të përsëriste. Faktikisht, kapaciteti i tij për të kuptuar dhe për të kujtuar është dukur menjëherë shumë i vogël, sikur edhe aftësitë e tij intelektuale. Ai iu është referuar rrethanave në mënyrë shumë të përgjithshme por ka qenë jashtëzakonisht preciz të lidhë, askush nuk e din pse, vizitën e Besnik Hasanit me vendin e shpërthimit të bombës në rrugën Bill Clinton! Qfare ka qenë lidhja ndërmjet këtyre dy fakteve? Qfare ka qenë rëndësia e një lidhjeje të quditshme ndërmjet dy fakteve të cilat nuk kanë, në sytë e dëshmitarëve, kurrfarë lidhje ndërmjet tyre? Për të vërtetuar kapacitetin e dëshmitarit për të kujtuar ka qenë e mjaftueshme, nga Kryetari i Trupit Gjyqësor, që ta pyes atë për datën e Deklaratës së Pavarësisë (datë kjo që besohet se rrallë ndonjë qytetar i Kosovës mund ta harrojë). Përgjigja hezituese ka qenë 17 Shtator.... Dhe, siq është e shënuar në procesverbal, vetëm pasi që atij i ka ardhur përgjigja e saktë

nga publiku i pranishëm në seancë dhe nga Avokati mbrojtës, ai ka qenë në gjendje të korigjonte vetën.

Kjo episodë ka vërtetuar atë që ka qenë evidente që nga fillimi për Gjykatësit me eksperiencë..do të thotë se dëshmitari nuk ishte i besueshëm dhe se dëshmia e tij nuk ishte e mirëfillte.

A A, e cila duhet të jetë alibia themelore, i ka ndryshuar versionet e saj gjatë procesit të hetuesisë si dhe gjatë procesit të shqyrtimit gjyqësor. Fillimisht, ajo ka tentuar të shmangë obligimin e saj për të dëshmuar, duke përmend ndjeshmërinë e qështjeve për të cilat pyetej ajo.⁵

Pastaj, gjatë marrjes në pyetje deklaratat e saja të mëparshme rregullisht janë përdorur për të freskuar kujtesën e saj dhe për të ballafaquar atë me ato që ajo ia kishte thënë hetuesve.

Versioni i saj se ajo e ka kaluar natën ndërmjet 23 dhe 24 Shtatorit 2007 nga 9.30/10.00 te mbrëmjes deri në orët e hershme të mëngjesit së bashku me Besnik Hasanin, është sfiduar nga Prokurorja me konsideratën se gjatë natës një numer i telefonatave ishin regjistruar ndërmjet telefonit të saj (044 868 368) dhe telefonit të Besnik Hasanit, dhe se të dy telefonat, në bazë të dëshmive së vendit të celularëve, kanë rezultuar të vendosur në lokacione të ndryshme. Kjo ka vërtetuar, ka qenë konkludim i Prokurores, se A A dhe Besnik Hasani nuk kishin qenë së bashku natën kritike dhe se alibia ishte e rrejshme. Telefoni i A At ishte gjurmuar në Ferizaj, ku ka jetuar, gjersa telefoni i Hasanit ishte gjetur në vende të ndryshme të Kosovës, nga Prishtina herët në mbrëmje, deri në zonën e Kaçanikut

Siç është theksuar nga Prokurorja në fjalën e saj përfundimtare (dokumenti me shkrim, fq.31) deklarata e A At ka ndryshuar me kalimin kohës. Fillimisht, ajo ka refuzuar të pranojë përdorimin e celularit që, siç ka thënë gjatë procesit të intervistimit të datës 26.6.08 (vëllimi 6), ajo nuk e ka pasur në kohën e ngjarjeve. Kur regjistrimet e komunikimeve të bëra me telefonin 044 8686 368 në telefonin e Besnik Hasanit (044 538 000) janë lëshuar që ajo ti dëgjojë gjatë intervistës së dytë ⁶ me 20 Shkurt 2008, ajo ka refuzuar të pranojë se zeri i dëgjuar i femrës ka qenë i saj. Te njëjtat regjistrime janë dëgjuar në Gjykatë, në Dubravë (dëshmitarja është thirrur përsëri për këtë qëllim me 30 Qershor 2009). Rezultati i dëgjimit shihej qartë nga Trupi Gjyqësor; Në biseda të ndryshme, dy zërat ishin vetëm të Besnik Hasanit dhe të A At. Pretendimi se telefoni 044 868 368 ishte përdorur nga halla e Besnik Hasanit thjeshtë ishte vetëm një gënjeshtër. Nuk nevojitet një ekspert të bëjë dallimin e zërit të një zonjushë të re me zërin e një gruaje të moshës rreth 60 vjeçare. Nuk nevojitet shumë që në thirrje telefonike të identifikohet zëri i veçantë i A At. Thjeshtë, është e paimagjinueshme të mohohet se një bisedë e tillë e dëgjuar në Gjykatë ka qenë e dashnorëve e jo i hallës apo i nipit. E njëjta A A ka qenë e vetëdijshme për këtë, dhe përkunder tentimit të pavlefshëm për të rezistuar (me pranime të limituara) identifikimin e zërit të saj në bisedat e inqizuara në kasete, ishte evidente, nga turpi i saj (të cekura sipas rregullit nga Kryetari i Trupit Gjyqësor në precesverbalin e seancës së datës 30 Qershor 2009, fundi i faqës 5) se ajo qartë i ka identifikuar zërat si qdo njeri me mirëbesim në këtë sallë të Gjykatës.

⁵ Adriana Ahmeti (25 Maj 2009, faqe 26); “ Nuk deshiroj të komentoje në këto...Une nuk do të mshefi asgjë por une kerkoje te perjashtohet publiku nese me beni pyetje te tilla.....Une nuk do te thoja se e kam jeten ne rrezik; eshte e shqetesuar per mua sepse jam Shqiptare, dhe sipas traditave tona ne duhet te jemi me intim; Une mund te tregoje kete para gjykates por e kam veshtire para publikut.”

⁶ Cfr.Raport Zyrtar, Volumi 9, fq 2676 dhe dokumenti i bashkangjitur

Për atë se telefoni nuk ka qenë pronë e Ardianës por asaj vetëm i është huazuar nga halla e Besnik Hasanit, kjo nuk mund të qëndrojë. Pa marrë parasysh se sa mirëbesim ka mundur të ketë pasur ndërmjet Ardianës dhe S St (nëse gjithashtu A A nuk e kishte përmendur prezencën e hallës dhe përdorimin e shturur të telefonit para dështimit të versionit të pare të saj të alibisë...) thjeshtë është jo logjike dhe e pa besueshme se një grua e moshuar ia ka dhënë telefonin A At në çfarëdo ore të ditës apo natës duke konsideruar se A A e ka pasur jetën e saj dhe punën e saj dhe se në anën tjetër Sabrje Saliu ka pasur shtatë djem dhe vajza që jetojnë jashtë vendit të cilat kanë mundur të kontaktojnë atë në telefon. Mirëpo, asnjë telefonatë nuk rezulton nga jashtë vendit në numrin e telefonit 044 868 368 dhe sqarimi i dhënë (telefoni do të përdorej nga halla vetëm për të thirrur nipin dhe jo anëtarët tjerë të farefisit) është thjeshtë i pabazë.

S S është thirrur të vërtetojë se numri i telefonit 044 868 368 është përdorur nga ajo (dhe jo nga Ardiana) dhe se ajo ia ka huazuar Adriana Ahmetit atë telefon me SIM kartelë, duke e vërtetuar me këtë versionin e dashnorës së Hasanit.

Duke qenë tërësisht e pamundur të kujtojë as gjera me rëndësi (në Ditën e Pavarësisë, ajo e ka ditur vetëm se ka ndodhur një vit më parë; për kapacitetin e saj për të shkruar dhe lexuar ajo ka thënë se ka harruar krejt çka ka mësuar gjatë shkollimit; për numrin e saj të telefonit asaj i kujtohen, në renditje të gabuar, vetëm tre numrat e fundit) ajo ka treguar precizitet ekstrem mbi natën pas shpërthimit të eksplozivit në momentin e kujtimit (me befasi të madhe të Kryetarit të Trupit Gjykses, i cili ka pranuar se ai nuk është në gjendje të kujtojë telefonatat nga një ditë në tjetrën) të një telefonate që ajo ia ka bërë nipit të saj Besnikut natën kritike dhe rrethana kur Ardiana ka shkruar atë natë me Besnik Hasanin. Ajo e ka ngjeshur deklaratën me sqarime të pabesueshme dhe absurde duke tentuar të përputhë atë me versionin e A At. Kur lexohet deklarata e saj, është lehtë të vërehen hutimet e shprehura nga Anëtarët e Trupit Gjykses gjatë ekzaminimit të saj.

Rashim Berisha është pronar i Motel Europa '92.

Ai ka dëshmuar në lidhje me prezencën e Besnik Hasanit në natën kritike, në kohën relevante në motel ku ai e ka marrë një dhomë për të "pushuar" me A An. Për të vërtetuar këtë version, dëshmitari ka treguar një agjendë të përdorur si regjistër ku emri i Besnikut ishte lajmëruar në natën ndërmjet 23 dhe 24 Shtatorit (supozohet në 2007).

Agjenda nuk mund ta jep asnjë garancion për vërtetësinë siç është evidente e këtë nuk mund ta bëjë as dëshmitari.

Ai gjithashtu ka një kujtesë të mrekullueshme e cila e lejon atë të kujtojë prezencën e klientëve në një distancë kohore prej dy viteve, ai e ka specifikuar të kujtojë datën e saktë për lidhjen e saj me shpërthimin e eksplozivit, ka dëgjuar në TV në një distancë kohore prej disa orëve nga vizita e Besnik Hasanit. Kjo lidhje, e përsëritur nga dëshmitarë të ndryshëm, ndërmjet Besnik Hasanit dhe lajmeve për shpërthimin në të njëjtën kohë është e dyshimtë dhe elokuate. E dyshimtë, pasi që nuk mund të kuptohet se pse një klient i thjeshtë, siç ishte Besnik Hasani, do të mbahej në mend në lidhje me vendosjen e bombës. Elokuate, pasi që rishfaqja e saj në dëshmi të ndryshme (F C, S S) tregon që ajo i është sugjeruar dëshmitarëve.

Së fundi, në dëshminë e Buhran Shkretes nuk është e mundur të gjendet asnjë vërtetim substancial i alibisë së paraqitur nga Besnik Hasani. Është e vërtetë se dëshmitari ka vërtetuar se koha që ai ka qene i udhëzuar nga babai i tij, që jeton dhe punon ne Gjermani bashkë me vëllezërit e Besnik Hasanit, që ti transferojë te akuzuarit Hasani 3,000.00 Euro në emër të afërmit të Besnik Hasanit. Mirëpo në kohën dhe ditën dhe rrathanat e pagesës nuk kane asnjë rastësi qe mund të vërtetojnë alibinë. Faktikisht, dëshmitari vetem i eshte referuar vizitës që Besnik Hasani ia ka bërë ëmbëltores së tij tij pasditen para shpërthimit te bombës (në ora 6.00 pasdite, siq iu eshte referuar deshmitarit nga kushëriri i tij Shefketi). Vizita e berë nga i akuzuari për ti marre paratë nuk ka pasur sukses sepse dëshmitari nuk ka qenë në ëmbëltoare në momentin e vizitës. Në thelb, dëshmitari nuk peshon në favor apo kundër alibise së paraqitur nga Besnik Hasani dhe duhet trajtuar si jo relevant në çfarëdo drejtimi.

Në përfundim, alibia e Besnik Hasanit është e pabazë sepse është e bazuar në deklarata të pasigurta dhe të rrejshme të dëshmitarëve (A A, F C and S S) të cilët kanë ardhur në gjykatë thjeshtë për të dhënë dëshmi të trilluara. Kjo nuk është befasi në një shqyrtim gjyqësor të ndikuar që nga fillimi nga virusi i dëshmimeve të rrejshme siq ceket më lart (faqet 8 – 10). Mirëpo në këtë rast pasoja është mjaft e rëndë.; Alibia që nuk është e vërtetuar mund te mos jetë relevante në vlerësimin e përgjegjesisë së të akuzuarit por alibia qe hetohet të jetë e rrejshme eshte vërtetim i drejtpërdrejt I qëllimit për të mbuluar përgjegjësinë e dikujt, prandaj duhet te merret, së bashku me elementet tjera qe tregojne kah i akuzuari, si demonstrim i përgjegjesisë së tij.

Si minimum, duhet theksuar se manipulimi i dëshmitareve të alibisë vërteton tendencën e Besnik Hasanit për të gënjer, për të trilluar rrethana te rrejshme, për të ndikuar në deshmitarët dhe për të shpikur arsyetime, që është stigmatizuar paragrafe të këtij vendimi.

2. Shpend Qerimi

Ai ka thene se ka shkuar ne turnir përkujtimor futbollit një natë para vendosjes së bombës. Ai ka ofruar dëshmitarë për të konfirmuar këtë.

Trupi Gjykues eshte i mendimit se edhe nëse vërtetohet alibia, ajo ka pak rëndësi.

Frustra probatur quod probatum non relevat. Rrethana se i akuzuari ka qenë i pranishëm ne turnir para mesnatës jashtë Prishtinës nuk përjashton atë se ai ka mundur të arrijë në Prishtinë disa orë më vonë.

3. Nusret Cena

Ne fjalët përfundimtare, Avokati Mbrojtes i tij ka cekur se nga raporti i regjistrimit te telefonit⁷ (044 326 006) te Nusret Cenes ka rezultuar se ai ka thirrur numrin 044 281 164 në ora 1.26 të mëngjesit..do të thotë për afersisht 40 minuta para se të shpërthejë eksplozivi. (rreth orës 2.10)

⁷ Cfr. Raporti i Daniel Tatomir i dates 25 Qershor 2008, Volumi 9, faqe 2852, I cekur nga Avokati Azem Vllasi ne fjalimin e tij përfundimtar, te versionit me shkrim, faqe 3.

Hartimi celular i telefonit tregon se telefonata është bërë nëpërmes celulës GSM Bregaca -2 në të njëjtin lokalitet, në jug të Ferizajit. Lokaliteti është mbi 50 Km jashtë Prishtinës në drejtim të kufirit me IRJM.

Natyrisht se ky element peshon në favor të akuzuarit me që e bën të pamundur se Cena ka qenë në gjendje të qëndroje në telefon në Bregacë e pastaj te arrij te Boulevardi Bill Clinton në një kohë aq të shkurtë.

Natyrisht, njeriu mund të diskutojë se dikush tjetër ka qenë në telefon në atë kohë, gjersa Cena ka mundur të ketë qenë rrugës për në Prishtinë. Mund të shtohet se kjo ka qenë parapregatitje e alibisë. Kjo konsideratë e fundit mund të kundërshtohet duke cekur se nëse ka qenë alibi e planifikuar, sigurisht ka mundur të bëhej në mënyrë më të mirë, duhe e thirrur telefonin e Cenës në një kohë më afër shpërthimit. Në anën tjetër, nuk është e qartë se pse vetëm Cena, sigurisht njeri që nuk ishte më drejtpërsëdrejti i interesuar të hakmerrë Triumf Rizën apo të frikesojë Sekiraqën, dhe në tërësi një figure anësore, do të mendonte paraprakisht të krijonte një alibi për vetën pa koordinim me të tjerët.

- - -

Përfundimet

Sasia e provave rrethore të mbledhura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe të paraqitura më lart e lejon Trupin Gjyqësor të vërtetojë përgjegjësinë e Besnik Hasanit dhe të Shpend Qerimit si pjesëmarrës në shpërthimin e bombës.

Nga ilustrimi i aspekteve të ndryshme të dëshmisë mund të përfundohet se ato janë koherente dhe se ato sigurojnë vërtetim të ndërsjellë.

Mundësia e sqarimit të ndryshëm të mozaikut të krijuar nga pjesë të ndryshme të dëshmisë është përjashtuar.

Që të dy Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi kanë dëshmi të forta kundër tyre.

Trupi Gjyqësor mendon se kjo pikë kërkon specifikim të mëtutjeshëm në lidhje me Shpend Qerimin në mënyrë që të mënjanojë përshtypjen se dënimi i tij është vetëm një reflektim i dënimit të Besnik Hasanit. Nuk është i tillë.

Përgjegjësia e Shpend Qerimit rrjedhë nga provat kundër tij dmth. pjesëmarrjen e tij në vrasjen e Neshat Baftiut dhe në prezencën e tij konstante në anën e Besnik Hasanit gjatë rrjedhës së ngjarjeve dhe në grindjen e tij (të Hasanit) me Enver Sekiraqën. Eventualisht, argumenti që e përgënjeshtëron alibinë e tij (shiqo më lart në fq.38) është një element tjetër.

Prezenca e konstatuar e Shpend Qerimit në natën e 27/28 Shtatorit në vendin e krimit të vrasjes së trefishtë dhe roli i luajtur nga ai në vrasje të trefishtë mund të sqarohet vetëm si marrje e përgjegjësisë për eliminimin e një dëshmitari potencial të rrethanave që janë relevante në rastin e shpërthimit të eksplozivit. Të mendosh se ai ka marrë pjesë në vrasje të trefishtë vetëm sepse ai ka dashur të bëjë një nder shokut të tij, apo se Besnik Hasani ka

kërkuar një gjë të tillë nga ai, pa kurrfarë lidhje me rastin që kishte ndodhur tri ditë më parë në Prishtinë, do të ishte vetëm naive dhe jo profesionale. Afërsia e tij me Besnik Hasanin është e dëshmuar mirë nga numri i telefonatavë ndërmjet tyre, nga e kaluara e tyre e përbashkët profesionale, nga huazimet e vazhdueshmë të dhëna Qerimit nga ana e Hasanit, nga patronazhi i ushtruar nga i pari ndaj të dytit⁸. Të gjitha këto konsiderata tregojnë një interes të përbashkët duke definuar fatin e përbashkët të së dy policëve. Prandaj duhet të arrihet në përfundim se ata kanë pasur të njëjtin nivel të përfshirjes në organizimin e sulmit në restorantin Sëkiraqa, edhe nëse për shkak të personalitetit Besnik Hasani e ka marrë rolin kryesor.

Një konsideratë e ngjashmë nuk mund të bëhet në lidhje me Nusret Cenën i cili gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor është paraqitur si një figurë sekondare. I lidhur me Besnik Hasanin nga një shoqëri e gjatë dhe e fortë dhe nga interesi i përbashkët biznesi (në fermë delesh), ai nuk është polic, prandaj ai nuk ka zhvilluar ndjenjën e urrejtjes dhe të opozitës ndaj grupit të Sëkiraqës, i cili ka dale gjatë procesit të gjykimit dhe që është kuptuar si motivues i madh prapa krimit. Të mendosh për pjesëmarrjen e tij në shpërthimin e eksplozivit vetëm për shkak të afërsisë së tij me Besnik Hasanin apo për vizitën që ai ia ka bërë shtëpisë së M Ismailit është e tepruar. Më tutje, jolidhëshmëria e tij me rrethin e oficerëve të policisë të cilët e kanë orkestruar dhe ekzekutuar shpërthimin e eksplozivit do të nënkuptonte një rrezik të madh të rrjedhës së informatës siq ka ndodhur më Neshat Baftiun. Mbi prezencën e tij në vendngjarjen e vrasjes së trefishtë, ky Trup Gjykues është i mendimit që identifikimi i një veture të ngjashme me veturën e tij nuk është element bindës. Mund të ketë shpjegim tjetër ose mund të përfshij një *quantum* të pjesëmarrjes në krim që nuk tregon domosdo edhe përgjegjësinë e tij për krimin në Bulevardin Bill Clinton. Mbi këtë çështje, trupi gjykues nuk dëshiron të shtojë asgjë tjetër, duke ia lënë vërtetimin e përgjegjësisë të ndryshme gjykatësit të çështjes së vrasjes së trefishtë.

Të gjitha këto konsiderata të kombinuara me alibinë e ekzaminuar më parë, në faqën 44 të këtij vendimi, çojnë në përfundimin se Nusret Cëna nuk është përgjegjës për krimet e cekura në aktakuzë.

- - -

Pas vërtetimit të faktve, janë të nevojshme disa vlerësime të kualifikimeve ligjore të krimeve.

Krimi i parë i listuar në aktakuzë është vrasje e rëndë në bashkë-kryerje në kundërshtim të Nenit 147, paragrafet 4, 9, dhe 11 dhe Nenit 23 të KPK.

Trupi Gjykues e kupton së vullneti i kryerësve të veprës penale nuk ka qenë i drejtuar kah vrasja e Naim Muratit dhe Pleurat Sllamnikut.

Kur të akuzuarit kanë vendosur eksplozivin nën shkallët e objektit të Restorantit Sekiraqa, qëllimi i tyre ka qenë që të shkatërrojnë objektin në mënyrë që të dëmtojnë atë dhe ti kërcënohen pronarit të Restorantit. Mirëpo, kryesit ë veprës penale e kanë ditur

⁸ Cfr. Telefonata ndërmjet Mona Ismailji dhe Besnik Hasani ne ‘djalosh i shkurte dhe i ndyre guy’, i.e. Qerimi me 18.10.07 ne 18.17

potencialin e mjëtit shpërthyes që ata e kanë pasur në dispozicion. Policët me përvojë kanë njohuri të mjaftuar për të kuptuar potencialin e detonimit të 7/8 kg të Nitropenta apo të eksplozivit të ngjashëm sintetik siq është përdorur në këtë rast me pasoja katastrofale. Kjo gjë nuk kërkon sqarim. Kjo duhet të jetë e qartë për secilin individ me një logjikë të shëndoshë dhe me një gjykim të mirë.

Pasojat vdekjeprurëse, siq janë ilustruar në raport dhe që kanë dalur qartë nga fotot e bëra në vendin e krimit kanë qenë të ndërlidhura me modalitetet e konstruksionit të objektit ku kanë qenë muret.

Kjo nuk i shfajëson kryesit e veprës të cilët i bartin pasojat e veprimit të tyre. Me vendosjen e bombës ata kanë paraparë efektin shkatërrues të objektit. Meqë ka ndodhur me modalitete të ndryshme prej atyre që janë pritur (jo përpjetë por anash) kjo nuk e ndryshon *mens rea* të krimit.

Prezenca e klientëve në kafenenë Prestige ishte e njohur për kryesit e veprës të cilët kishin kaluar përmes rrugicës ku ka qenë kafeneja në mënyrë që të arrijnë para ndërtesës dhe hyrjes së Restoranit Sekiraqa.

Ata i kanë pranuar pasojat shkatërruese dhe vdekjeprurëse të shpërthimit. Kryerja e qëllimshme e veprimit, me fjalë tjera, i ka kapur pasojat e mundshme të veprimit dhe i ka pranuar ato si dëm kolateral. Në këto terme një *dolus eventualis* (I cili është një formë tjetër e *dolus indirectus*) e përshkruan më së miri vullnetin e kryesve të veprës. Një gjëndje specifike mendore ku këtu kemi parashikimin e një numri të varianteve të mundshme të rrjedhimit të veprës penale duke përfshirë viktimat.

Pasojat më të rënda mund të mos janë si qëllim direkt i veprimit, megjithatë ato konsiderohen si të pashmangshme dhe të pranuar në arritjen e qëllimit. Vullneti i kryesit (kryesve) të veprës penale duke mos hequr dorë nga pasojat e parashikueshme dhe të parapara vdekjeprurëse demonstronë mbizotërimin e përkushtimit kriminal mbi interesat tjera (mbrojtja e jetës, integritetit trupor ose pronës) të cilat pra janë të degraduara dhe të zhdukura.

Në përfundim, në lidhje me vrasjen e Naim Muratit dhe Pleurat Sllamnikut, kualifikimi i faktevë si vrasje është korrekt dhe ky kualifikim rëndohet nga prezenca e rrethanave të listuara në numër 4, 9 dhe 11 të nenit 147 të KPP. Që të tri rrethanat mund të identifikohen lehtë në relacion me numrin e jetëve të rrezikuara, me ligësinë e arsyeve dhe për numrin e viktimave shkaktuara nga kjo vepër. Të gjitha këto rrethana, që janë të qarta në mendimin e Trupit Gjykuës nuk kërkojnë një ilustrim specifik.

Faktet e përshkruara në akuzën e dytë duhet të rikualifikohen meqë kualifikimi fillestar si tentim vrasje nuk duket të jetë si saktë.

Sa i përket lëndimit trupor që iu është shkaktuar një numri të madh të viktimave nga shpërthimi, kualifikimi si tentim vrasje duket të jetë i tepruar. Qëllimi që është implicit në tentim të kryerjes së veprës penale është disi i papërshtatshëm me *mens rea* të nënvizuara lartë, do të thotë *dolus eventualis*.

Neni 154 parag 1, numër 1 i KPK i përshkruan faktet e akuzës më mirë meqë lëndimi trupor i shkaktuar disa (nëse jo të gjitha) palëve të lënduara ka qënë mjaft i ashpër sa për të rrezikuar jetën. Ky rikonstuksion ka beneficionin e kualifikimit të dy veprave penale si të kryera.

Në anën tjetër, rrezikimi i jetës së më shumë personave gjithashtu përfshihet në rrethanat rënduese p.4. i nenit 147 të KPK.

Qështja e fundit.

Në përfundim të fjalës së saj përfundimtare, Znj Prokurore ka sugjeruar që nëse Trupi Gjykues nuk ka gjetur elemente të mjaftuara që përcaktojnë përgjegjësinë penale të Nusret Cenës për faktet e përshkruara, ai edhe ashtu do të kishte kompetenca të konsiderojë faktet e vërtetuara gjatë procesit të gjykimit dhe ti rikualifikojë ato në lidhje më Cenën si mossukses të njoftimit për pregatitjen e veprave penale apo /dhe mossukses të raportimit të veprës penale (nenet 303/304 KPK), meqë qartë është shfaqur dhe duhet të konkludohet, prandaj Cena ka pasur njohuri për sulmin dhe për pjesëmarrësit në sulm.

Trupi Gjykuës nuk mund të ndajë këtë pikëpamje.

Elementet e veprave penale të listuara në aktakuzë dhe ato të veprës penale të shprehura së fundi janë rrënjësisht të ndryshme. Ato nuk mund të ndryshohen në fund të gjykimit sepse i akuzuari Cena kurrë nuk e ka pasur mundësinë e mbrojtjes së vëtvetës nga akuza e mossuksesit për të bërë lajmërimin.

Në konkludim të aktvendimit, edhe disa konsiderata të përgjithshme mbi gjykimin dhe për tre të akuzuarit;

Motivi i veprës penale dhe qëllimi i saj janë ilustruar më lart. Ne ë këmi parë se vullneti që e ka karakterizuar veprimin (shpërthimin e eksplozivit) ka qënë i përbashkët. Ne mund të shtojmë se kushti psikologjik që posa themelohet lidhë në mënyrë reciproke anëtarët e grupit të cilët kanë marrë pjesë në krim. Është shkeljë që në mënyrë eksplicite (për fjalët e thëna apo kërkësat e shtruara nga dikush në grup) apo në mënyrë implicite (për kodin e nderit (besën) ndërmjet individëve së të njëjtit mjedis) përfshinë rregullën e qetësisë që ndalon ndonjë pjestar, nëse zbulohet dhe arrestohet, të zbulojë hetuesve apo gjykatësve identitetin e pjesëtarëve të tjerë në vepër.

Kjo është mjaft evidente në rastin aktual.. Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi janë dy nga 6 oficerët e policisë që kanë marrë pjesë në shpërthimin e eksplozivit. Ku janë të tjerët? Ata ende shërbejnë në uniformë përkundër asaj së qka kanë bërë. Dhë kjo sepse dy të akuzuarit nuk ë kanë marrë mbi vete përgjegjësinë ë veprës së tyre as në fund të shqyrtimit gjyqësor. Natyrisht së kjo është zgjedhje e lirë në të cilën Trupi Gjykues nuk mund të ndërhyjë, meqë do të ishte shkelje e rregullës *nemo tenetur se detegeree* (askush nuk është i detyruar të akuzojë vetën). Por Trupi Gjykues ka vërejtur se sjellja e të akuzuarit është reflektim i rregullës së heshtjes e shfaqur më parë e cila ndalon indikacionin e bashkë pjesëmarrësve, sepse do të shihëj si tradhti dhe do të dënohej si e

tillë. Siq është e ditur në qarqet kriminale, si dhe në kontekstin e vjetër kulturor, ndjenja e besnikërisë është ë pakontestuar edhe nëse ajo shkelë detyrat ndaj shoqërisë demokratike. Shkelja e kodit të tillë të nderit do shkaktonte një zemërim dhe turp të madh ndaj “kallëzimitarit” Do të thotë së vullneti i themeluar fillestar për të kryer shpërthimin e eksplozivit ende është i gjallë dhe i qartë dhe detyruës në të dy të akuzuarit për këtë aspekt dhe përbën pengesë të pakapërcyeshme për ata për tu bërë dëshmitarë bashkëpunues të Prokurorjasë. Në vend që të zgjedhin një opcion gjykimi më të përshtatshëm (duke u bërë dëshmitarë bashkëpunues ata kanë mundur të mbështetën në nen dhe të binin në ujdi për një marrëveshje me Prokurorjan apo të deklarohën fajtorë dhe kështu të mundësonin uljen ë konsidëruar të dënimit me burg) ata kanë preferuar të përballën më shqyrtim gjyqësor dhe të marrin dënimin e plotë. Për besnikërinë e vullnetit fillestar kriminal dhe të këtyre kodevë të vjetra dhe të tëjkaluara të nderit, nuk ka mundësi të arsyetohet një zvogëlim i dënimit.

Ashpërsia e dënimit në këtë rast arsyetohet me dy faktorë: Në një anë me pasojat vdekjeprurëse të krimit e në anën tjetër me funksionin zyrtar të akuzuarit. Sipas mendimit të Trupit Gjykues, qka e bënë krimin jashtëzakonisht të ligë dhe të tmërrshëm është rrethana së ai është kryer nga një rreth i oficerëve të policisë. Duhet të theksohet dhë të kujtohet se ky grup i gjashtë personave nuk e përfaqëson Policinë ë Kosovës por përbëjnë një grup të devijuar të saj. Në mendojmë, ne dëshirojmë të besojmë se antitrupat e institucionit janë të mjaftuara në parandalimin e përhapjes së infeksionit. Megjithatë, fakti se ai veq ka ndodhur në një shoqëri të vogël, në një Shtet të sapo themeluar, i shkakton popullatës mosbesim në institucion, ndjenjë të tradhtisë, të pafuqisë dhë të braktisjes. Në një shprehje, ndjenjën e humbjes së çiltërsisë dhe iluzionit të shoqërisë për integritetin e saj moral.

Sikur fjalët e fundit të folura nga Avanturieri Kurtz në momentin para vdekjës (*‘Tmerri! Tmerri!’*), në *Zemra e Territ* të Josef Conrad thirrja e përsëritur në porosinë e M Ismailit ‘Vëllai...e ka gjuajtur dinamitin, *Oh Zot, Oh Zot*’ është ilustrimi më i drejtëpërdrejtë i kësaj ndjënjeje të neveritjes dhe tmerrit.

Trupi gjykues konsideron që për vrasjet e dy viktimave, burgimi afatgjatë në kohëzgjatje prej 25 viteve është dënim adekuat. Mjaft afër minimumit për burgim afatgjatë (që shqiptohet në kohëzgjatje prej 21 deri në 40 vite burgim, ex neni 37 KPPK), dënimi megjithatë duhet të reflektojë që qëllimi i kryesit nuk ka qenë i drejtuar ndaj vrasjeve, të cilat më tepër janë pasojë e thirrjes së faktorëve negativ.

Këtij dënimi afatgjatë do të shtohen 3 vite burgim për krimin ex neni 154 KPK dhe edhe 3 vite tjera burgim për shkelje të nenit 291, paragrafet 1 dhe 5 KPK.

Në bazë të dispozitës mbi dënimin e veprave penale të bashkuara, neni 71 para. 1 and 2, p. 1, 2 e Kodit Penal të Kosovës, të akuzuarit Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi do të vuajnë dënimin afatgjatë prej 25 viteve burgim.

Kërkesa pasurore juridike

Kërkesat e paraqitura nga palët e dëmtuara gjejnë konfirmim të gjërë në deklaratat e dëshmitarëve dhe në dokumentet e dosjes. Natyra dhe ashpërsia e dëmeve gjithashtu janë konfirmuar.

Prandaj, të akuzuarit Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi, bashkarisht, do të kompensojnë palët e dëmtuara Arife Murti, Zyhrije Murti, Guri Murti, Bardh Murti, Avni Murti dhe Fadil Murti për dëmet e shkaktuara.

Megjithatë, shënimet e siguruara në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurtë as për vendim të plotë e as të pjesshëm.

Siç parashihet në nenin 112 (2) të KPPK, palët do të duhet të paraqesin kërkesë në kontest civil me qëllim që të bëhet vlerësimi përfundimtar i shumës së dëmeve.

Shpenzimet e procedurës penale

Sipas Neneve 102, para. 1 dhe 3 dhe 391, para. 1 pika 6) e KPPK, të pandehurit janë kumulativisht dhe bashkarisht përgjegjës për shpenzimet e procedurës penale dhe duhet ti kompensojnë ato sipas një liste të shpenzimeve e cila do të përcaktohet në kohën e duhur.

Sipas Nenit 100, para. 2 të KPPK, pasi që shënimet mbi shumën e shpenzimeve mungojnë, do të lëshohet një aktvendim I veçantë mbi shumën e shpenzimeve.

26 Shtator 2009

Gjykatësi kryesues, raportues

Procesmbajtëse

Francesco Florit

Nexhmije Mezini

KËSHILLË JURIDIKE:

Palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit sipas Nenit 398 para. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Gjykatës Supreme të Kosovës nëpërmes Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.